



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit
Katedra e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe**

STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA:

Vështrime etnolinguistike në disa vepra të Murat Isakut

Kandidati:

Almira Memishi

Mentor:

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

Tetovë,

2019

Përmbajtja

MIRËNJOHJE	5
HYRJE.....	6
LËNDA E HULUMTIMIT.....	7
QËLLIMET E HULUMTIMIT	7
HIPOTEZAT	7
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	8
METODOLOGJIA E KËRKIMIT	9
RËNDËSIA E PUNIMIT	9
I. SHQYRTIME TEORIKE	10
ETNOKULTURA	10
<i>a. Nofkat.....</i>	<i>10</i>
<i>b. Eufemizmat</i>	<i>10</i>
<i>c. Urimet dhe fjalët përkëdhelëse</i>	<i>11</i>
<i>d.Mallkimet popullore.....</i>	<i>12</i>
<i>e. Ngushëllimet</i>	<i>12</i>
<i>f.Ofendimet (sharjet).....</i>	<i>12</i>
2. ONOMASTIKA	13
<i>a.Emrat e banimit dhe tempujve.....</i>	<i>13</i>
<i>b.Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti.....</i>	<i>14</i>
<i>c.Emra kafshësh</i>	<i>14</i>
3. LEKSIKOLOGJIA	16
<i>a. Fjalët e urta</i>	<i>16</i>
<i>b. Njësitë frazeologjike.....</i>	<i>18</i>
<i>c. Neologjizmat</i>	<i>18</i>
<i>d.Dialektizmat</i>	<i>20</i>
<i>e. Arkaizmat</i>	<i>21</i>
<i>f. Historizmat.....</i>	<i>21</i>
FOLKLORI	22
II. ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E VEPRAVE	23
VEPRA I	23
ROMANI “RRENGU “	23
1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE.....	24
<i>a) Përdorimi i nofkave</i>	<i>24</i>
<i>b) Përdorimi i eufemizmeve.....</i>	<i>25</i>
<i>c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse.....</i>	<i>25</i>
<i>ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....</i>	<i>25</i>
<i>d) Përdorimi i ngushëllimeve</i>	<i>25</i>
<i>e) Ofendimet (sharjet).....</i>	<i>26</i>
2. SHQYRTIME ONOMASTIKE	26
<i>a) Emrat e banimit dhe tempujve.....</i>	<i>27</i>
<i>b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti</i>	<i>27</i>
<i>c) Emra kafshësh</i>	<i>27</i>
3. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE.....	27
<i>a) Pasqyrimi i fjalëve të urta.....</i>	<i>27</i>
<i>b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike.....</i>	<i>28</i>
<i>c) Pasqyrimi i neologjizmeve</i>	<i>29</i>
<i>ç) Pasqyrimi i dialektizmeve</i>	<i>29</i>
<i>d) Pasqyrimi i arkaizmeve.....</i>	<i>29</i>
<i>e) Pasqyrimi i historizmeve.....</i>	<i>29</i>

f) Pasqyrim i huazimeve.....	29
4. SHQYRTIME FOLKLORIKE	30
VEPRA 2	31
ROMANI “GËRSHETAT”	31
1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE.....	32
a.Përdorimi i nofkave	32
b. Përdorimi i eufemizmave.....	32
c.Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse	32
d. Përdorimi i mallkimeve popullore.....	32
e. Përdorimi i ngushëllimeve	33
f. Ofendimet (sharjet).....	33
e. Betimet.....	33
2. SHQYRTIME ONOMASTIKE	34
a.Emrat e banimit dhe tempujve.....	34
b.Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti	34
c.Emra kafshësh	34
3. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE	35
a. Pasqyrimi i fjalëve të urta.....	35
b. Pasqyrimi i njësive frazeologjike	35
c. Pasqyrimi i neologjizmave	36
d. Pasqyrimi i dialektizmave.....	36
e. Pasqyrimi i arkaizmave.....	36
f. Pasqyrimi i historizmave	36
g. Pasqyrimi i huazimeve.....	37
4. SHQYRTIME FOLKLORIKE	37
VEPRA 3	38
ROMANI “FATPRERËT”	38
1. SHQYRTIME ETNOKULTURORE.....	39
a) Përdorimi i nofkave	39
b) Përdorimi i eufemizmave	39
c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse.....	40
ç) Përdorimi i mallkimeve popullore.....	40
d) Përdorimi i ngushëllimeve.....	40
dh) Ofendimet (sharjet).....	41
2. SHQYRTIME ONOMASTIKE	41
a) Emrat e banimit dhe tempujve	41
b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti	42
c) Emra kafshësh	42
3. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE.....	42
a) Pasqyrimi i fjalëve të urta	42
b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike	43
c) Pasqyrimi i neologjizmave	43
ç) Pasqyrimi i dialektizmave.....	44
d) Pasqyrimi i arkaizmave.....	44
e) Fjalë pasive : ndofta , sofra , etj	44
f) Pasqyrimi i historizmave.....	44
g) Pasqyrim i huazimeve.....	44
4. SHQYRTIME FOLKLORIKE	44
III – ANALIZË SEMANTIKE KRAHASUESE E VEPRAVE TË MURAT ISAKUT	46
PËRDORIMI I NOFKAVE NË TRI VEPRAT	46
Përfundime.....	46
PËRDORIMI I EUFEMIZMAVE NË TRI VEPRAT	47
Përfundime.....	48

PËRDORIMI I URIMEVE NË TRI VEPRAT E MURAT ISAKUT	49
PËRDORIMI I FJALËVE PËRKËDHËLËSE NË TRI VEPRAT E MURAT ISAKUT	50
PËRDORIMI I MALLKIMEVE POPULLORE	52
PËRDORIMI I NGUSHËLLIMEVE	54
PËRDORIMI I OFENDIMEVE (SHARRJEVE).....	56
II. SHQYRTIME ONOMASTIKE	59
EMRAT E BANIMIT DHE TEMPUJVE	59
EMRAT DHE MBIEMRAT SI SHENJË INDENTITETI.....	61
EMRA KAFSHËSH	64
III. SHQYRTIME LEKSIKOLOGJIKE.....	65
PASQYRIMI I FJALËVE TË URTA	65
PASQYRIMI I NJËSIVE FRAZELOGJIKE	67
PASQYRIMI I NEOLOGJIZMAVE.....	70
PASQYRIMI I DIALEKTIZMAVE	72
PASQYRIMI I ARKAIZMAVE	74
PASQYRIMI I HISTORIZMAVE.....	76
PASQYRIMI I HUAZIMEVE.....	77
IV. SHQYRTIME FOLKLORIKE	80
PASQYRIMI I VARGJEVE TË KËNGËVE	80
PASQYRIMI I INSTRUMENTEVE POPULLORE MUZIKORE	82
ANALIZË STATISTIKORE	83
BERONJË, NOF. "RRENGU"	84
PËRFUNDIM	103
LITERATURA.....	105
PËRMBLEDHJE	107
РЕЗИМЕ.....	108
SUMMARY	109

Mirënjohje

Dua të shpreh falënderimet dhe mirënjohjen për prof.dr Mustafa Ibrahim, për përkrahjen e vazhdueshme dhe ndihmesën e dhënë për realizimin e këtij punimi.

Një falënderim i veçantë është edhe për shoqërinë time që kanë besuar tek unë që në fillim të studimeve e deri më sot.

Falënderimi më i rëndësishëm, që u jam mirënjohëse gjatë gjithë jetës, janë familja ime e dashur, që dhanë një kontribut të veçantë në përkrahjen time, motivimin dhe besimin e dhënë në finalizimin e këtij punimi dhe gjithë rrugëtimit në përgjithësi.

Hyrje

Studimet gjuhësore në gjuhën shqipe në ditët e sotme janë të shumta, duke trajtuar, çështje, fenomene apo dukuri, që u përkasin rrafsheve të ndryshme, në studime, referate apo monografi. Studiues të shquar të gjuhës shqipe, si Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Shaban Demiraj, Mahir Domi, Idriz Ajeti kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm, duke bërë studime me rezultate konkrete në disiplina të ndryshme dhe duke krijuar kështu shkencën tonë gjuhësore.

Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se për personalitetin e Murat Isakut janë bërë studime të shumta, por ne e pamë të arsyeshme që në këtë kurorëzim të studimeve master të marrim Murat Isakun si autor në një aspekt krejt të veçantë, me titull : “Vështrime etnolinguistike në disa vepra të Murat Isakut”. Struktura e kësaj teze masteri përbëhet nga hyrja, më pas kemi tre veprat “Rrengu”, “Gërshetat”, “Fatprerët” e Murat Isakut.

Në Kreun e Parë të punimit kemi shkruar për shqyrtimet teorike; për etnokulturën, nofkat, eufemizmat, urimet dhe fjalët përkëdhelëse, mallkimet popullore, ngushëllimet, ofendimet dhe sharjet. Më pas kemi pjesën e onomastikës: Emrat e banimit dhe tempujve, Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti, Emra kafshësh. Më pas kemi pjesën e leksikologjisë: fjalët e urta , njësitë frazeologjike, neologjizmat, dialektizmat, arkaizmat, historizmat. Më pas kemi pjesën e folklorit. Në kreun e dytë kemi analizën etnolinguistike të veprave.

Duke filluar me veprën “Rrengu” , “Gërshetat” dhe “Fatprerët” . Pra këto tre vepra janë pjesë e tezës së masterit. Në kreun e tretë kemi: analizën semantike krahasuese të veprave të Murat Isakut. Më pas kemi shqyrtimet onomastike, shqyrtimet leksikologjike, shqyrtimet folklorike e pastaj kemi analizën statistikore, fjalorthin e termave dhe në fund përfundimin dhe literaturën e shfrytëzuar .

Lënda e hulumtimit

Murat Isaku lindi në Gajre të Tetovës më 1928, vdiq në moshën 77 vjeçare në Tetovë në vitin 2005. Mësoi në Tetovë, Elbasan, Prishtinë, Prizren, maturën e mbaroi në Normalen e Gjakovës, studimet e larta për gjuhën dhe letërsinë i mbaroi në Beograd më 1953. Punoi si profesor i gjuhës shqipe në gimnazin e Tetovës dhe mëtej u emërua zv. drejtor i kësaj shkolle. Duhet theksuar se u caktua redaktor i TV Shkupit për emisionet e gjuhës shqipe nga edhe u pensionua.

Ai la pas vetes dhjetra vepra letrare në vargje e në prozë, që përbëjnë grumbull kujtesash ku janë sistemuar epoka historish të dhimbshme të një pjese pothuajse të panjohur në krahasim me vendet tjera shqiptare.

Gjuha e përdorur e autorit në veprat e tij studiohet edhe në raportin gjuhë-kulturë, kjo u pa e arsyeshme pasi veprat e Murat Isakut janë të stërmbushura me elemente etnolinguistike. Në brendi të veprave të tij janë regjistruar edhe biseda të ndryshme origjinale popullore dhe materiale tjera dialektore, me të cilën i jepet një dimension i ri folklorik dhe kulturor.

Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të studiohet vepra e Murat Isakut edhe në aspektin e raportit mes gjuhës dhe popullit, gjegjësisht me kulturën materiale dhe shpirtërore, mentalitetin dhe krijimtarinë popullore, vepra e tij do të studiohet edhe në karakterin leksikologjik, prandaj lirisht këtë studim mund ta quajmë studim interdisiplinar. Veprat e tij janë të stërmbushura me elemente etnolinguistike gjë që të bën t'i hyjsh më thellë këtij hulumtimi mjaft me interes për studiuesit e gjuhës. Në brendi veprat e Murat Isakut janë përplot me biseda të ndryshme popullore, materiale dialektore, folklorike, arkaike etj. Këtu kemi të bëjmë me kulturën tradicionale të popullit shqiptar ku hyjnë: bisedat e përditshme, histori të ndryshme, rrëfime, punë të përditshme, këngë popullore, përralla, proverba, poezi, përshendetje, doke, zakone, tradita, rituale të dasmave, lindjeve, vdekjeve etj, mallkime, urime, studime onomastike si: nofkat, emrat, mbiemrat, toponimet si dhe studime leksikore si: homonimet, sinonimet, neologjizmat, historizmat, dialektizmat, arkaizmat.

Hipotezat

Duke lexuar veprat e Murat Isakut hasim shumë elemente të etnolinguistikës, gjë që pasqyron kulturën dhe historinë e popullit shqiptar, si nga aspekti lokal, rajonal dhe ai kombëtar duke përfshirë mentalitetin e një populli në përgjithësi, gjegjësisht popullit shqiptarë.

Metodologjia e hulumtimit

Fazat e kërkimit

Faza përgatitore

1. Studimi i literaturës
2. Leximi i veprave
3. Formulimi i platformës studimore

Faza e mbledhjes të të dhënave

1. Materiale etnolinguistike
2. Materialet leksiko-frazeologjike
3. Materiale sociolinguistike

Shqyrtimi i të dhënave dhe analiza e tyre

1. Përqasja me studime të mëparshme, duke plotësuar analizën për vepra të tjera të pa hulumtuara
2. Analiza e veçorive etnolinguistike, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë
3. Analiza e veçorive sociolinguistike të frazeologjisë, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë
4. Analiza e veçorive leksikore, duke e parë në vështrim përqasës me punime të mëparshme në këtë fushë

Shqyrtime të thelluara dhe mbështetëse për veprat e Murat Isakut

Përgjithësime dhe përfundime.

Metodologjia e kërkimit

Duke u nisur nga qëllimi i punimit, metodologjia e kërkimit u mbështet në shqyrtimin etnolingistik dhe leksikor të veprave të Murat Isakut duke ndjekur dy drejtime:

1. së pari, leximi në përgjithësi i veprave të Murat Isakut, si dhe literaturës hulumtuese për këto vepra, nxjerrja e materialit të nevojshëm për hulumtim

2. së dyti, shqyrtimi i materialit faktik mbi bazën e literaturës teorike për të dhënë një pamje të plotë leksiko-frazeologjike, sociolinguistike dhe etnolinguistike të gjuhës së përdorur të Murat Isakut në veprat e tij.

Rëndësia e punimit

Hulumtimi *Vështrime etnolinguistike të veprave të Murat Isakut*, deri sot nuk i është dhënë rëndësi dhe nuk është hulumtuar në sasi të mjaftueshme. Pikërisht për këtë, ky hulumtim ka vlerë të madhe gjuhësore, etnolinguistike, leksikore, sociolinguistike.

Meqë, kemi mungesë të studimeve për këtë çështje, pra për studimin gjuhësor të veprave të Murat Isakut, pamë të arsyeshme që të hulumtojmë këtë temë me qëllim që të ju shërbej studiuesve tjerë që do të merren me këtë problematikë.

I. SHQYRTIME TEORIKE

Etnokultura

Etnokultura shqiptare në këndvështrimin e disa autorëve anglez dhe francez. Në vështrimin e mjaft autorëve anglez dhe francez të shekullit XIX-XX, pasqyrohet jeta zakonore kultura artistike dhe materialet e shqiptarëve, të cilët nxjerrin në dritë këtë pasuri të çmuar dhe kontaktet e saj me qytetërimin mesdhetar dhe evropian. Në studimet e mjaft autorëve të huaj shpalosen mjaft elemente të kulturës shpirtërore, të antropologjisë kulturore dhe të etnopsikologjisë së shqiptarëve. Mbi të gjitha vëmë në dukje se këndvështrimi i tyre ndriçon disa nga aspektet e jetës zakonore rriteve dhe miteve nëpër bashkësinë e tyre në popujt e mesdheut.

a. Nofkat

Nofkat janë emra familjarë ose humoristike që u vihen personave ose dhe sendeve në vend të emrave të tyre të vërtetë. Nofkat mund të jenë hipokoristike (nofka përkëdhelie për të shprehur afërsinë ose lidhjet me personin që po cilësojmë). Nofkat e ashtuquajtura zvogëluese përdoren edhe këto për të shprehur afërsi apo familjaritet. Një pjesë e madhe e nofkave janë fyese dhe ofenduese. Nofkat nuk zgjidhen, ato u adresohen personave pa miratimin e tyre dhe nuk përdoren gjatë komunikimit të drejtpërdrejtë si emër përcaktues për folësin. Si koncept, nofkat duhet të dallohen nga pseudonimet apo titujt. Sipas FGJSSH (1980) “nofka është emër i dytë që i vihen dikujt për tallje, për shaka apo përkëdheli duke u nisur nga ndonjë e metë fizike a ndonjë tipar dallues”, ndërsa sipas Q. Muratit “Turlitava gjuhësore ballkanike përmes ofiqeve dhe nofkave na flet qartë për psikologjinë dhe etnografinë e të folurit të popujve përkatës. Si shprehje e një arkaizmi provincial ata kanë krijuar një mal nofkash në gjuhët e tyre” (Murati, 2012, p. 351).

b. Eufemizmat

Eufemizmat mund të kundrohen për nga forma e brendshme e tyre, e cila vjen nga perceptimi i një referenti të dyfishtë, prej të cilëve njëri ngrihet në të shenjuar. Pra, forma e brendshme të eufemizmat mund të gjendet në mënyrë të tërthortë. Një ide e tillë shtëllitet nga mjaft studiues që janë marrë me këtë lëndë gjuhësore-etnografike. Sipas prof. Çabejt “Ata (eufemizmat) kanë vlerë mbasi nëpërmjet tyre ne njihemi me historitë e popujve të ndryshëm, me lashtësinë, veçoritë kombëtare, shkallën e zhvillimit, kushtet ekonomike, doket, zakonet. Ato lidhen me mitet dhe besimet me burim vendas dhe janë shprehje e ruajtjes së veçorive kombëtare

të popujve. Këtu pasqyrohet më së miri të folurit e figurshëm të gjuhës popullore. Eufemizmat janë dukuri gjuhësore e përditshmërisë sonë, të cilat edhe pse mendohej se u përkasin kohëve të vjetra jo vetëm që nuk kanë shteruar, por po shtohen me sajesa a formime të reja. Eufemizmi është një figurë që zbut realizimin e disa ideve apo fakteve dhe që si antifraza bën që një fjalë apo shprehje të përdoret me një kuptim të ndryshëm nga ai që ka në realitet. Eufemizmat lindën në shoqërinë primitive dhe shumë prej tyre janë të lidhura me fenë dhe bestytinë. Njerëzit në kohët e lashta besonin se gjuha nuk ishte thjesht një simbol, por njëkohësisht ajo kishte edhe një pushtet magjik. Ajo mund t'u sillte njerëzve në të njëjtën kohë edhe fatkeqësi edhe mbarësi, prandaj vetë njerëzit i shmangnin nga përdorimi fjalë të tilla të konsideruara tabu dhe zëvendësohen nga shprehje të tjera të përafërta. Duke qenë se eufemizmat me përkufizim janë fjalë ose shprehje të stërholluara, të zbutura apo të zgjedhura me marrëveshje në mënyrë të logjikshme mund të mendojmë se kuptimi i tyre i vërtetë mund të jetë më i keq se ai i dukshmi (ai që shfaqet). Eufemizmat më shumë se çdo njësi tjetër gjuhësore janë të rrënjosura në ndërgjegjen kolektive, janë tregues dhe mishërues i plotë i lidhjeve të bartësve të gjuhës me truallin që u ka rënë për pjesë të ndajnë dhe janë dëshmi e gjallë e ndasive kohore, mendësore, kulturore që ata përcjellin. Prof. Shkurtaç ka pohuar se “Eufemizmat nuk janë vetëm dukuri e të folurit të njerëzve të moshuar, e grave pa shkollë, të atyre që mund t'i quanin të prapambetur e të tejkaluar. Jo, aspak, ato na ndjekin pas sot e gjithë ditën, ndonëse tashmë edhe me risime e përditësime të nevojshme” modernizuese”.(Shkurtaç, 2004: 257)

c. Urimet dhe fjalët përkëdhelëse

Urimi nuk është tjetër veçse një akt i të folurit që shpreh një qëndrim ndaj sjelljes dhe fatit të të tjerëve. Urimi është shprehja e një dëshire me fjalë, që pritët të realizohet në një kohë të ardhshme. (Coulmas 1981:154). Urimi mund të shprehet me shumë lloje formulash rituale që ndryshojnë sipas ndjenjave dhe situatave (Shkurtaç 2001:77). Përsëritja në përgjithësi është shprehja gjuhësore paraprake apo e zanafillës për çdo ndërshkëmbim kulturor: ajo pasqyron një traditë të lashtë sa vetë njeriu, d.m.th. të drejtuarit me fjalë dhe nisjen e një komunikimi të vërtetë midis dy vetave; ajo është pikënisje për komunikimin, prandaj ka edhe një funksion të rëndësishëm gjuhësor (Arcuri 2000, 135-162). Qysh nga mëngjesi kur ngrihet e deri në mbrëmje kur përmbyll veprimtarinë e shtrihet për të fjetur, njeriu është i përfshirë në një qerthull sjelljesh (qëndrimesh) e shkëmbimesh ndërvetjake, të cilat me kohë janë bërë pothuajse stereotipa e madje, gati të vetvetishme, por që nisin të gjitha me një përsëritje.

Fjalët përkëdhelëse - Që ka një ngjyrim zbutës e mirëdashës; që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zburim. Që shpreh dashuri a dashamirësi; që shpreh ëmbëlsi e butësi; i këndshëm, i pëlqyeshëm; ledhatues.

d.Mallkimet popullore

Gjuha popullore veçohet për kuptimin e thënies, që vijnë nga studimi i rrethanave në të cilat kryhet biseda, përdoren gjeste e mimika, veçohet ritmi i shpejtuar, fjalitë janë më të shkurtra, folësit ndjehen më të afërt. Mallkimet popullore si shfryrje e mllëfit dhe shkarkimit shpirtëror të thëna përmes fjalëve - si forcë magjike, përdoren nga të gjitha shtresat popullore, duke filluar prej plakave dhe pleqve e deri te fëmijët. Mallkimet janë paraqitur si rezultat i mungesës së aftësisë së shpjegimit të ligjërive të shumë fenomeneve natyrore siç ishin krijesat irracionale, si shtriga, lugetër, kuçedra etj.. Kjo mosdije bëri që frika prej këtyre fenomeneve të shtohet. Njeriu ishte i bindur se këto krijesa irracionale kishin aftësi dhe forcë, madje të mbinatyrshme. Andaj njeriu i druante, dhe në analogji me këtë, ai nisi t'i druajë edhe mallkimet. Kështu mallkimet u bënë armë e më të dobët dhe të pambrojtur për t'iu kundërvuar më të fuqishmit. (Ibrahimi 2006:76). Ndër mallkimet më të shpeshta janë ato me të cilat mallkohet individi. Me rëndësi është se edhe në përdorimin e mallkimeve paraqiten veçori dalluese sipas gjinisë, gjegjësisht gruaja përdor tjera mallkime në krahasim me burrin, edhe pse këto mallkime i njohin të dy gjinitë, por nuk është i vogël numri i atyre mallkimeve që përdoren nga të dy gjinitë. (Mustafa Ibrahimi H. X., 2006, p. 76) Pjesë e gjuhës popullore janë dhe mallkimet, që bëjnë pjesë në njësitë frazeologjike. Mallkimet janë pasqyrim i gjendjes emocionale të folësve, flasim për gjendje të rënduar, kur njeriu ndihet i pafuqishëm, por që beson fuqishëm, se fjalët e tij do të kthehen në veprime. Dëshira që këto fjalë të kthehen në fatkeqësi për të mallkuarin rezulton në përdorimin e vazhdueshëm të mënyrës dëshirore dhe nga shqiptimi i tingujve me intensitet jo të zakonshëm. (Dodi, 2004, p. 193)

e. Ngushëllimet

Fjalët dhe ndjenjat që shprehim për të ngushëlluar dikë kur i vdes një i afërm. Gjatë vdekjes së ndonjë personi ndjehet dhimbje e ndodh të qahet dhe të vajtohet. Krejt ceremonia e vdekjes është e pleksur edhe me një varg shartesh e dokesh , në të cilat ka pasur edhe praktikime të një të foluri karakteristik te gratë sepse te burrat nuk përdoren të njëjtat.

f.Ofendimet (sharjet)

Fjalë a shprehje fyese, e rëndë dhe e pahijshme, që i themi dikujt, e sharë. Sharje e rëndë (e ulët).

2. Onomastika

Onomastika është pjesë e rëndësishme e leksikologjisë, që merret me kuptimin, prejardhjen dhe shtrirjen e emrave të përveçëm si: emrat vetjakë, nofkat dhe pseudonimet (antroponimet), emrat familjarë ose siç i quajmë ndryshe edhe mbiemra (patronimet) që përbëjnë dhe njëzën nëndarje si dhe emërtimet e vendeve dhe objekteve gjeografike (toponimet), që përbëjnë edhe nëndarjen tjetër të onomastikës që në vetvete këto kanë nëndarje të tjera. Onomastika në përgjithësi dhe toponimia në veçanti, për çdo gjuhë, përbëjnë një lëndë të vlefshme që mund të plotësojë në një masë të mirë mungesën e dokumenteve të shkruara. Ajo mbetet “arkivi gojor” i historisë dhe lashtësisë së kulturës të çdo kombi. Ndër hulumtimet e para rreth lashtësisë e të gjuhës shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, studiuesit i janë drejtuar pikërisht onomastikës së trojeve ku kanë qenë të parët tanë. Ndër hulumtimet e para rreth lashtësisë e të gjuhës shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra të Ballkanit, studiuesit i janë drejtuar pikërisht onomastikës së trojeve ku kanë qenë të parët tanë. Materiali i parë onomastik fillimisht është futur në përdorim nga rilindësit shqiptarë, por i paargumentuar shkencërisht. Fillesat i kemi me studiuesit e huaj si Majer, Jokli, Kreçmer, Hahn, Nopça etj, të cilët i janë referuar gjerë studimeve onomastike për të provuar origjinën e shqipes, për të kaluar më pas tek studiuesit shqiptarë, që janë të shumtë në numër, nga të gjitha trevat shqipfolëse. (Bello 2012:522)

a.Emrat e banimit dhe tempujve

Emër quhet ajo pjesë e ligjeratës që emërton qenie të gjalla dhe sende dhe ka kategoritë gramatikore të gjinisë, të numrit, të rasës dhe të shquarsisë e të pashquarsisë. Autorë të shumtë shqiptarë përdorën në veprat e tyre emra të ndryshëm të vendlindjes së tyre. Këta emra janë shumë të lashtë dhe kishin historinë e tyre, të cilat ishin bartur brez pas brezi deri në ditët e sotme. Emrat e banimit dhe vendeve kanë luajtur një rol të rëndësishëm si në jetën shoqërore po ashtu edhe në atë letrare. Burim frymëzmi i çdo autori shqiptarë ishte pikërisht vendlindja dhe i gjithë folklori së bashku me doket, zakonet dhe emrat e vendbanimeve të rrethit në të cilin kanë jëtuar. Këtu vendin kryesorë e kishin fshatërat e malësive ku jetonin dhe vepronin poulli shqiptar.

TEMPULL *m.* 2. fig. Vend që i ngjall dikujt nderim të thellë; diçka që nderohet a çmohet shumë, diçka që mbahet si e shenjtë e si e paprekshme. Tempujt janë ndërtesat më të bukura dhe më të vështirat për tu ndërtuar. Ata janë shumë të lashtë duke filluar nga tempujt e vjetër indian (egjiptian, grek e romak).

Arkitetkët dhe ndihmesa e njerëzve punëtorë, ishin ata të cilët arritën të ndërtonin këto vepra të mëdha historike të njohura ndryshe si tempuj. Këto ndërtesa sot kanë zënë një vend të rëndësishëm në kulturën e çdo populli të botës, sepse nëpërmjet tyre tregohet lashtësia e dhe historia e tyre. Në historinë e popullit shqiptarë këto ndërtesa (tempuj), zënë një vend mjaft të rëndësishëm në kulturën tonë. Lashtësia e tyre ishte e lidhur ngushtë edhe më jetën e popullit dhe me emrat e vendbanimeve të ndryshme. Me një fjalë këto tempuj ose ndryshe siç njihen si faltore, ishin bërë pjesë e pandarë edhe e letërsisë së shkruar nga e cila autorët krijojnë dhe thurjnë poezi, himne e trillime të ndryshme mbi lashtësinë e tyre dhe rëndësinë që ato kanë në jetën tonë të përditshme. Edhe në letërsinë shqipe këta tempuj, faltore ishin mitizuar dhe ishin bërë të pavdekur. Mali i Tomorrit është një tempull mitik dhe hyjnor, sepse aty gjenden kulmet, shkëlqimi i lavdisë dhe i madhështisë së gjenezës sonë si popull.

BANIM *m.*

1. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve BANOJ, BANOHET. Shtëpi (ndërtesë) banimi. Sipërfaqe banimi. Leje banimi. Vend (qendër) banimi. Gjurmë banimi. Përdor për banim.
2. Vendi ku banojnë njerëzit për një kohë të gjatë, vendbanim. Banim i lashtë (prehistorik). Me banim të përhershëm (të përkohshëm). Me banim të panjohur.
3. vjet. Banesë. (FGJSH, 2006 :245).

b.Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti

Shqiptarët , edhe pse me tri fe të ndryshme , prej shekujsh kanë krijuar një fond të pasur emrash kombëtar , qoftë fetarë , tashmë të përvetuar fonetikisht sipas ligjeve të shqipes , qoftë laikë : emra ilirë ose personalizime fjalësh të lëksikut të përgjithshëm . Megjithatë, emrat vetjakë , më tepër se çdo kategori tjetër fjalësh , pësojnë ndryshime të ndjeshme në varësi të rrethanave shoqërore, kulturore e politike të një vendi . (Ibrahimi 2012 :219)

c.Emra kafshësh

Emrat e përveçëm janë fjalë që emërtojnë veta, frymorë të tjerë dhe sende të veçanta, që bëjnë pjesë në një klasë sendesh të një fare, pa pasur në vetvete asnjë tregues të veçantë të klasës së cilës i përkasin (Petrit, Agron, Balo, Berat, Korab, Myzeqe, Sazan). Në emrat e përveçëm përfshihen:

1.Emrat dhe llogaritjet e njerëzve, pseudonimet: Vjollcë, Flutur, Genc, Konstandin Kristoforidhi, Shkurte Vata, Migjeni (pseudonimi i Millosh Gjergj Nikollës);

2.Emrat e kafshëve: Balo, Kuqal, Laro, Murro;

3.Emrat gjeografikë: (tëlumenjve, maleve, deteve, shteteve, krahinave, qyteteve, rrugëve, shesheve etj.): Drin, Tomor, Mesdhe, Karaburun, Sazan, Shqipëri, Azi, Krujë, rruga“Konferenca e Pezës”, sheshi “Skëndërbej”etj.;

4.Emrat e periudhave dhe ngjarjeve historike: Rilindja, Kongresi i Manastirit, Revolucioni i Qershorit, Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare;

5.Emrat e institucioneve, të organizatave, të ndërmarrjeve etj.: Fakulteti iHistorisëdhe i Filologjisë, Ministria e Arsimit, Kryesia e Kuvendit Popullor, uzina“Partizani” etj.;

6.Titujt e veprave letrare, të gazetave e të revistave: “Lulet e verës”, “Vargjet e lira”, “Zëri i popullit”, “Rilindja demokratike”, revistat “Nëntori”, “Studime filologjike” etj.;

7.Emrat e trupave qiellorë: Arusha e Vogël, Jupiteri, Marsi etj.

3. Leksikologjia

“Leksikologjia është shkencë gjuhësore, që studion fjalët si njësi leksikore dhe leksikon, d.m.th. tërësinë e fjalëve, nga ndërtimi, nga kuptimi, nga shtresimi i mundshëm etj” (Thomai, 2006, p. 7) Në librat e kësaj fushe, është synuar të paraqitet zhvillimi i gjuhësisë shqiptare, arritjet e saj, sidomos deri në dhjetëvjeçarin e parë të shek. XXI dhe zhvillimet e fundit, pastaj të vendoset një simetri në mes të degëve të kësaj fushe. Kështu më në imtësi janë studiuar tema si: formimi i fjalëve, frazeologjia, norma gjuhësore, leksikografia etj. . Tekstet e kësaj natyre i gërshetojnë njohuritë teorike, historike dhe praktike. Leksikologjia shqipe mori trajtat e një shkence në shekullin e XX. “Në periudhën para viteve ’40 të atij shekulli janë bërë hapa me rëndësi në kërkimet leksikologjike, sidomos për të nxjerrë në dritë pasurinë leksikore e frazeologjike të shqipes, për ta pastruar atë nga lënda e huaj dhe për ta pasuruar me njësi e krijime prej brumit të vet”. Në periudhën e Rilindjes përveç pavarësisë së popullit, me ngulm punohej që shqipja të pastrohej nga fjalët e huaja, kështu u arritën përgjithësime dhe shënime për fjalët e shqipes. Mbetet edhe sot për t’u admiruar kontributi i lëvruesve të leksikologjisë shqipe: Sami Frashëri, Konstandin Kristoforidhi, Aleksandër Xhuvani e shumë të tjerë, pastaj nga të huajt: Gustav Majeri, Norbert Jokli etj. Megjithatë shekulli i kaluar përfundoi me një sërë zbrazëtish, kjo pasi studimet mbështeteshin kryesisht në nisma të veçanta, studimet kryheshin më shumë për krahasime dhe në dobi të gjuhëve tjera se sa për të nxjerrë në dritë pasurinë e shqipes. Studimet shpesh nuk kishin bazë të shëndoshë teorike, zgjidhjet në plot raste ishin joshkencore dhe kryheshin nga dijetarë të shkollave të ndryshme. “Leksiku dhe frazeologjia shqipe vlerësohen si pasuri kulturore e përbashkët kombëtare, që duhet mbledhur e studiuar me synimin që të shërbejë për zhvillimin e gjithanshëm të shqipes standarde, për ta bërë këtë gjuhë sa më të fuqishme e më shprehëse” (Thomai 2006:15) Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Siç është vërtetuar tashmë përfundimisht, ajo përbën një degë të veçantë të familjes gjuhësore indoevropiane, por nuk ka lidhje birërie me asnjë nga gjuhët e kësaj familjeje, me gjithë afrinë në sistemin gramatikor e në leksik që ka me to. (Thomai 2006:15)

a. Fjalët e urta

Në letërsinë gojore fjalët e urta perceptohen si formë e veçantë, si një lloj letrar me të cilin shqiptohen gjykime e vlerësime të mirëfillta situatash e shfaqjesh, të cilat lindin prej jetës materiale e shpirtërore, prej përvojës shumëshekullore, prej praktikës dhe veprimtarisë popullore. Ato paraqesin urtësinë e filozofinë e popullit, mendimin e psikologjinë, ndërjegjen e tij artistike

dhe estetike. Në lidhje me realitetin dhe perceptimin gjithëpërfshirës ato japin përfundime e konstatime, që rrjedhin pas një analize e sinteze dhe verifikimi të gjatë jetësor. Si të tilla kanë vlera të shumta dhe synojnë ta përgatisin njeriun, ta udhëheqin në punë, në sjellje, në përpjekjet e tij si qytetar i një shoqërie të caktuar. Një lidhje e tillë e fjalëve të urta me jetën, me problemet e kohës, me mjedisin dhe kushtet konkrete, me ndërgjegjen dhe me psikologjinë reale të vendit, dëshmon për sensin e theksuar realist të folklorit në kultura të vendeve të ndryshme. (Panajoti, Xhagolli1987: 10 – 11.) Është e rëndësishme të vihet re se interesi për fjalët e urta është shumë i lashtë, sepse ato duke shërbyer si burime për transmetimin e ideve sjellin informacione për të gjithë ata që duan të kenë mbështetje (akses) në traditën dhe njohjen e tërësisë së fjalëve të urta më të përdorura në vendin autokton, në rastin tonë Shqipërinë, pastaj Anglinë, Amerikën dhe vendet e tjera anglishtfolëse. Për këtë arsye dhe për shumë të tjera fjalët e urta janë shumë të vlefshme për studime me qëllime sociolinguistike. Për qëllimet tona, është e rëndësishme të themi se, fjalët e urta përgjithësisht konsiderohen bashkime speciale frazeologjike. Në këtë kontekst, është thelbësore të nxjerrim në pah që kërkimet mbi studimin e fjalëve të urta nuk kanë dalë vetëm prej frazeologjisë, por edhe prej disiplinave të tjera shkencore, sidomos prej shkencës së letërsisë e veçanërisht prej letërsisë gojore e të folkloristikës. Fjalët e urta kanë kuptim e përdorim të drejtpërdrejtë e të tërthortë. Në rastin e parë, në funksion të drejtpërdrejtshmërisë përdoren për ta vërtetuar thënien paraprake, kurse në rastin e dytë, kur janë në funksion të tërthortë artistik, përdoren për t'i tërhequr vëmendjen bashkëbiseduesit t'i përmirësojë veprimet e veta. Në këtë mënyrë, ato plotësojnë funksionin e tyre estetik edukativ e mësimor. Pra, fjalët e urta përveç kuptimit praktik utilitar njohës e sinkretik, kanë edhe kuptimin figurativ, me të cilin përgjithësojnë dhe tipizojnë dukuri të lloj-llojshme jetësore. Për to është karakteristike shprehja e plotë, e përgjithësuar e mendimit, e ndjenjës dhe vendosja e porosisë, e cila bëhet e kuptueshme vetëm nga konteksti, në të cilin është përdorur. Kjo edhe është njëra nga prirjet e tyre kryesore për shprehjen e mendimit në mënyrë figurative. Ky parim i lejon proverbit jo vetëm të bëjë përgjithësime të gjera, por në të njëjtën kohë, i jep karakter polisemik dhe sa më i gjerë, sa më i përgjithësuar të jetë mendimi, aq më i bukur është kuptimi i figurshëm. Prandaj, fjalët e urta më të bukura janë ata që kanë mundësi të ofrojnë më shumë se dy e tri mënyra interpretimi. Rrënjët e lindjes së fjalëve të urta, në disa raste, përkojnë me ato të lindjes së fabulave, legjendave, përrallave e anekdotave e të llojeve të tjera të letërsisë gojore dhe është e vështirë të përcaktosh fillesën e krijimit të tyre. (Berisha 1997: 261).

b. Njësitë frazeologjike

Termi frazeologji vjen nga gjuha greke: phrasis, ka kuptimin: shprehje, njësi e ligjëritimit; dhe logos: dije ose dituri. Njësitë frazeologjike kanë kuptim të mëvetësishëm, fjalët e bashkuara kanë ndërtim të qëndrueshëm dhe pas një kohe përfundojnë si njësi të pandashme. Përgjithësimi i tyre në përdorim i kthen një pjesë në frazeologji thjeshtë gjuhësore, por fjalët mbi të gjitha kanë valencën shprehëse. “Togfjalëshat me veçoritë e tyre, shërbejnë si një burim shprehësie. Përftesat me frazeologjinë janë një lloj përpunimi i saj, i cili i rigjallëron, i bën të ndjeshme veçoritë e ndërtimit e të semantikës së tyre, që janë ngurosur po ashtu siç fshihet forma e brendshme e fjalës pas ndërtimit të saj. (Lloshi, 1999:124) Frazeologjia është një fushë e gjerë studimi. Ka shumë probleme që meritojnë vëmendje të posaçme edhe në studimet tona të ardhme, zgjidhja e të cilave merr një rëndësi praktike gjatë hetimit të fjalorëve të gjuhës shqipe e sidomos në këtë fazë të studimeve përgjithësuese në lëmin e leksikut të shqipes. (Thomai, 1981:2) Njësitë frazeologjike dëshmojnë jo vetëm në gjuhën e folur si të lashta, po edhe me shkrim, që me dokumentet e para shqip, shpesh herësi formime më të hershme se njësitë leksikore sinonime me to. Si dhe vetë gjuha, ato janë një prodhim historik e, për pasojë, janë zhvilluar e ndryshuar krahas leksikut dhe gjuhës shqipe në përgjithësi.(Thomai1981: 2)

c. Neologjizmat

Neologjizëm vjen nga greqishtja neos=i ri, logos=fjalë. Justin Rrota i përkufizon kështu neologjizmat: “Janë neologjizme njato fjalë a mënyra të reja, qi nuk i bën gjuha, për arsye ma së fortit se janë qitun pa mendue e pushue mirë. Flitet këtu vetëm për njato fjalë e të thanme të reja, të trajtueme pa marrë parasysh natyrën e gjuhës shqipe, e të përkthyme krejt si janë në një gjuhë të huaj.” Sterjo Spasse jep këtë përkufizim: “Neologjizmat janë fjalë e të folme të reja. Neologjizmat krijohen me shumicë, kur bëhen ndryshime të mëdha e të shpejta në jetën e shoqërisë. Neologjizmat i krijon vetë populli ose dhe shkrimtarët: Neologjizmat formohen prej fjalësh që i ka vetë gjuha. P. sh. gjatë Rilindjes u krijuan ndër të tjera këto neologjizma: ndërgjegje, përgjegje, përemër, mbiemër, fletore etj. (Spasse, 1964: 29) Për të krijuar neologjizma të vlefshme e të përdorshme duhet pasur parasysh natyra e gjuhës shqipe, d.m.th. mënyra e formimit të fjalëve me anën e rrënjëve, parashtesave dhe prapashtesave të gjuhës sonë. Në “Fjalorin shpjegues të termave të letërsisë” thuhet për neologjizmat: “Fjalë që hyjnë herë pas here në gjuhë për të shënuar sende e fenomene të reja. Neologjizmat e kanë prejardhjen nga fjalë të huaja (sputnik, pulovër, çek etj.), nga fjalë të krijuara prej dijetarëve për nevoja të shkencës dhe teknikës, duke u mbështetur në gjuhët greke e latine (gjeometër, fonogram, stilograf etj.), duke

përshtatur një fjalë dialektore ose duke u dhënë një kuptim të ri fjalëve ekzistuese (qelizë, etj.) duke krijuar fjalë të reja me anë parashtesash, prapashtesash ose kompozita (paramendim, cepatar, shumëngjyrësh etj.). ” Shumë fjalë që kanë pasuruar gjuhën shqipe kanë hyrë në fillim si neologjizma. Të tilla janë fjalët: pronar, shtypshkronjë, asnjanes, frymëzoj, shumëngjyrësh etj. Neologjizmat krijohen edhe nga shkrimtarët, kur duan të shprehin me forcë të re ndonjë dukuri. Megjithatë thesari i gjuhës popullore jep shumë mundësi për të mënjeluar krijimin e fjalëve të reja të panevojshme. Neologjizmi është dukuria e krijimit të fjalëve, termave ose frazave të reja që mund të futen në fjalorin e gjuhës. Në gjuhën e shkrimtarëve vihet re tendenca për krijimin e fjalëve të reja të përbëra, në të shumtën e rasteve me formime shqip, por ndonjëherë edhe me formime joshqip. Krijimi i këtyre neologjizmave, si edhe përdorimi i disa shprehjeve tërheqëse për nxënësin e ndihmojnë atë në zgjerimin e leksikut të tij. Neologjizmat kanë karakter historik, ata janë të tillë për një kohë të caktuar . Neologjizmat mund të kenë burim popullor dhe atëherë mbeten anonim. Neologjizmat nuk përbëjnë hop a përmbysje në gjuhë , po një zhvillim të natyrshëm e shkallë-shkallë , sepse përndryshe brezat njerëzorë s’do të merreshin vesh ndërmjet tyre. (Thomai 2006: 267) Arkaizëm vjen nga greqishtja arkhaismos=diçka e lashtë, e vjetër. Justin Rrota thotë për arkaizmat: “Thirren këso dore njato fjalë e mënyrë të përdoruna prej shkrimtarësh së hershëm e qi sod, nëpër njatë zhvillim, qi shkon tue ba gjuha, janë lanë m’anesha janë xëvendsue me tjera.” (Rrota, 2006: 18.) Në “Fjalorin shpjegues të termave të letërsisë” jepet ky përkufizim: “Arkaizmat janë fjalë, shprehje dhe forma gramatikore të vjetruara, të cilat nuk jetojnë më në gjuhën e gjallë. Të tilla në gjuhën shqipe janë: gjellë(jetë), pagëtyre(pagesë), fëdigë(mundim) dhe shprehjet: e madhe pjesë, e madhe frigë etj. Arkaizmat përdoren ndonjëherë në ato vepra ku pasqyrohet e kaluara dhe në këtë rast ndihmojnë për të dhënë më me vërtetësi ngjyrën e kohës. Mjeshtret e fjalës, në veprat artistike me karakter historik, kur përdorin arkaizma, i zgjedhin nga ato që kuptohen lehtë dhe e kufizojnë shumë numrin e tyre. ” (Spasse 1964:29) Siç thekson Xhevat Lloshi, “Arkaizmat bëjnë përshtypje në disa raste edhe për trajtën tingullore ose fjalëformimin tashmë të pazakontë. Sami Frashëri kalkoi nga greqishtja fjalën “gjithëmësime” për universitet. Tashmë sa herë del kjo temë në gojëtarin i drejtohen pikërisht kësaj fjale që sot është jo më neologjizëm, por e vjetruar... Fan Noli e ka arritur arkaizimin e gjuhës te “Marshi i Barabajt” me një mjeshtëri të veçantë, duke ndërthurur shumë përftesa, madje duke i ngritur orientalizmat deri te stili biblik. (Lloshi, 2005:108) Neologjizmat duhet të jenë të kuptueshme dhe të natyrshme, sepse arrihet efekti i kundërt kur shprehësia mbështetet tek shmangiet dhe teksti del me ton të fryrë e të papranueshëm.

d.Dialektizmat

Leksiku dialektor kufizohet nga territori, ai është leksik i një dialekti a i një të folmeje të veçantë territoriale. Fjalët dialektore ose krahinore janë ato fjalë që përdoren vetëm në njërin dialekt a të folme të caktuar, që nuk përdoren në dialektin tjetër a në të folmet e tjera; p. sh. në të folmet e Veriut: zhgjandërr, turrë, me fashitë, çikë, me bujtë etj; në të folmet e Jugut: kumbullore, kaposh, tërkuzë, mbodhisem etj. Krahinore janë edhe fjalët ollonar “korrik”, brazimë “brymë”, dybek “tundës”, gushëpiper “gushëkuq”, korit “turpëroj”, “thi” “derr”, nadje “mëngjes” etj. Leksikologjia i trajton me hollësi fjalët dialektore dhe krahinore ose kuptimet e tyre: Kemi fjalë dialektore ku në dialektin tjetër ajo nuk përdoret fare, sepse për të njëjtin koncept ka një fjalë tjetër, si tambël “qumësht”. b) Kemi kuptim dialektor kur fjala njihet në të dy dialektet, po një kuptim i saj nuk njihet në dialektin tjetër, p. sh. qasem-“largohem” (Shqipëri e Mesme) – “afrohem” (Myzeqe); e ligë -“shtatzënë” (Në Jug)-“e sëmurë” (Në Veri).

Dialektizmat duhen parë edhe nga një anë tjetër, në se për ta ka ose jo një fjalë tjetër të përbashkët në shqipe; P. sh. në Jugkumbullore-në Veri molla t’arta-e përbashkët domate; në Jug koce, keçe-në Veri cucë, çikë-e përbashkët vajzë; në Jug gjiton-në Veri komshi-e përbashkët fqinj etj. (Thomai, 2002: 244).

Dialektizëm vjen nga greqishtja dialektos = e folme lokale. Quhen edhe krahinorizma ose provincializma. Justin Rrota i quan idjotizme. Ai bën këtë përkufizim: “Idjotizmet, qi quhen edhe provincializme, janë fjalë e mënyra së shprehurit, të përdoruna vetëm në ndonji dialektit, nëndialekt a krahinë të vendit, të lanuna m’anesh prej shkrimtarësh të mirë, të cillat u largohen trajtavet të vërteta të gjuhës”. (Rrota, 2006:17). Ai jep edhe shembuj sidomos nga Shkodra, Mirdita, Dibra etj. Sterjo Spasse i përcakton kështu dialektizmat: “Krahas me gjuhën letrare gjendet edhe gjuha që flitet, ajo gjuhë në të cilën flet masa e gjerë e popullit. Të mos harrojmë se gjuha letrare formohet duke pasur për bazë gjuhën që flet populli. Por të gjitha fjalët që flet populli në krahina të ndryshme nuk mund të hyjnë në gjuhën letrare. Fjalë të tilla të përdorura ka nëpër dialektet e krahinave të ndryshme të një vendi dhe këto nuk janë bërë pronë e përgjithshme e tërë popullit. Këto lloj fjalësh quhen dialektizma ose provincializma”. (Spasse, 1964:29).

Dialektizma ky studiuës quan: modhë (për mollë), Shqypnaj (për Shqipni), unë kom (unë kam) etj. Dialektizmat nuk janë vetëm fjalë, por edhe shprehje të tëra. Rrallë herë ndonjë shkrimtar i përdor në gojën e ndonjë personazhi për individualizim me anë të gjuhës, duke treguar prejardhjen e tij krahinore. Në “Fjalorin shpjegues të termave të letërsisë” thuhet përdialektizmat: “Fjalë që përdoren vetëm në një krahinë e territor të caktuar dhe nuk i përkasin mbarë gjuhës. ”Dialektizmat përdoren për të shënuar ndonjë objekt ose koncept që nuk e ka fjalën përkatëse në

gjuhën letrare ose për të kryer ndonjë funksionstilistik, duke zëvendësuar fjalët me të njëjtin kuptim në gjuhën letrare.

e. Arkaizmat

Arkaizëm vjen nga greqishtja arkhaismos=diçka e lashtë, e vjetër. Justin Rrota thotë për arkaizmat: “Thirren këso dore njato fjalë e mënyrë të përdoruna prej shkrimtarësh së hershëm e qi sod, nëpër njatë zhvillim, qi shkon tue ba gjuha, janë lanë m’anesha janë xëvendësue me tjera. ” Ai na bën me dije se arkaizmat janë shumë pak në gjuhën shqipe. Disa prej tyre mund t’i ngjallim e t’i futim në punë, por disa të tjera jo, sepse përndryshe gjuha shqipe do të na dukej e rëndë dhe trashamane. Shkrimtarët i përdorin ndonjëherë arkaizmat kur flasin për një epokë të lashtë, me qëllim që të japin atmosferën dhe koloritin e veçantë të kësaj epoke.

Në “Fjalorin shpjegues të termave të letërsisë” jepet ky përkufizim: “Arkaizmat janë fjalë, shprehje dhe forma gramatikore të vjetruara, të cilat nuk jetojnë më në gjuhën e gjallë. Të tilla në gjuhën shqipe janë: gjellë (jetë), pagëtyre (pagesë), fëdigë (mundim) dhe shprehjet: e madhe pjesë, e madhe frigë etj. Arkaizmat përdoren ndonjëherë në ato vepra ku pasqyrohet e kaluara dhe në këtë rast ndihmojnë për të dhënë më me vërtetësi ngjyrën e kohës. Mjeshtrat e fjalës, në veprat artistike me karakter historik, kur përdorin arkaizma, i zgjedhin nga ato që kuptohen lehtë dhe e kufizojnë shumë numrin e tyre. ” Arkaizmat janë fjalë a shprehje të vjetra që përdoren pak ose nuk përdoren fare, zakonisht sepse janë zëvendësuar me fjalë të tjera. Kur fjalët shënojnë diçka, që lidhet vetëm me një periudhë historike të kaluar, ato quhen historizma. Autorët i shfrytëzojnë për të dhënë kohën, mjedisin, si dhe për karakterizimin e gjuhës së personazhve.

Për shembull: fjalët shqytë, pasha, vakt, vatan, sokak, istikam, vergji, përderës(lypës), letëror (letrar, shkrimtar), hijezë(çadër), shpërenj(shpresoj), defter(fletore) janë arkaizma. Ismail Kadare ka përdorur shumë arkaizma veçanërisht te romani “Kështjella”: “Që këtej dukeshin flamurët e bardhë si dëbora të jeniçerëve dhe kazani i tyre prej bakri, që po e lidhnin në një pemë të madhe. Akënxhinjtëpo çonin kuajt për të pirë ujë te lumi i vogël. Tutje, si në mizëri pa fund, zbardhnin çadrat e azapëve. Pas tyre vinte moria e çadrave të eshkynxhinjve dhe pastaj vinin me radhë çadrat e dallkëllecëve, të sendergjeshlerëve, të ushtarëve myselemë, çadrate bukura të spahinjve.

f. Historizmat

Historizmat , janë përdorur në një periudhë të caktuar kohe dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë, si heshtë . shqytë, kumbara, breshana,

aga, vergji, pasha etj. Si arkaizmat edhe historizmat janë fjalë të vjetëruara dhe nuk përfshihen në leksikun e gjuhës letrare. (Ibrahimi 2014:106) Arkaizmat janë fjalë a shprehje të vjetra që përdoren pak ose nuk përdoren fare, zakonisht sepse janë zëvendësuar me fjalë të tjera. Kur fjalët shënojnë diçka, që lidhet vetëm me një periudhë historike të kaluar, ato quhen historizma.

Folklori

Folklor- Tërësia e krijimeve artistike (gojore, muzikore, vallet etj.) të një populli. Folklori ynë shqiptar zhvillohet nëpërmjet estetikës, kalon evolucionin e tij, por nuk humbet; madje, sa më shumë vitet kalojnë, aq më shumë vlerat e tij rriten, pasi të gjithë kemi nevojë dhe duam të dimë për origjinën tonë dhe gjithçka lidhur me të. Estetika është një art që nxit shpirtin, trupin, mendjen tonë dhe çdo element të saj e lidh me ndjenjën dhe gjendjen e thellë shpirtërore. Estetika dhe elementi i së bukurës së vërtetë dhe të hijshme janë shprehje të ngjashme, të cilat përcjellin një emocion dhe kanë të njëjtin kuptim cilësor që e përdorim shpesh për të treguar diçka që na pëlqen. Të jetosh me të bukurën estetike-folklorike, do të thotë të shikosh dhe të përjetosh cilësi të pafundme tradicionale-folklorike shqiptare.

Një karakteristikë tjetër e veçantë është që ne si popull kemi fatin që nga bartësit tanë të hershëm, kemi marrë në duart tona dhe njëkohësisht kemi njohur folklorin tonë shqiptar tepër të kulluar dhe origjinal. Në mënyrë tepër fisnike ato e kanë transmetuar te ne folklorin origjinal dhe pa ndryshime. Bartës të këtyre pasurive shpirtërore janë kryesisht njerëzit e moshuar, të cilët kanë praktikuar folklorin në mënyrë tepër fisnike dhe e kanë përcjellë atë në brezat e rinj. Rëndësia folklorike është një element i cili duhet të ruhet me fanatizëm edhe nga brezat e rinj dhe duhet ditur se ky brez i ri ka për detyrë ta marrë folklorin dhe ta pasurojë më shumë dhe më thellë, duke iu nënshtruar gjithmonë një procesi shkencor.

Procesi shkencor është tepër i rëndësishëm, sepse ai na ndihmon akoma më shumë të bëjmë një studim të thellë rrënjësor të traditës, të zakoneve, të tekstit, të historisë së valles mbi zonat e saj gjeografike, mbi kushtet dhe rrethanat sociale kur ajo është praktikuar, mbi shoqërimin muzikor e deri te format dhe mënyrat ekzekutuese të saj.

II. ANALIZA ETNOLINGUISTIKE E VEPRAVE

Vepra I

Romani ‘RRENGU ‘

Murat Isaku në veprën e tij romani “Rengu” trajton temë nga e kaluara, por që është tejet aktuale për ditët tona, edhe këtu kthehet te fatkeqësitë tona të shumta. Sikurse në të gjitha veprat e tij edhe në romanet e më vonshme ngjarjet zhvillohen mbi një galeri personazhesh të cilët shpesh i hasim buzë katandisjes fizike. Xhelë Preja te romani “Rengu” të lindur me psikologjinë se liria qëndron mbi çdo vlerë, protestojnë në emër të drejtësisë dhe së vërtetës kundër vetëdijes autoritare, kundër forcave rënuese shpirtërore, kundra atyre që mbjellin farën e frikës dhe gjendjes së nënshtrimit. Gatishmëria e heronjëve epik për flijim nuk nënkuptohet si gjestilacione rasti, por si domosdoshmëri. Burgjet dhe zandanet ku vuajnë të pafajshmit janë perandori sëmundjesh të padukshme. Sot e kësaj dite burgjet për ne shqiptarët janë bërë çerdhe torturash të ndërtuara sipas Xhelatëve. Në këtë perandori pushteti është në duartë e errësirës, kurse njerëzit viktimat e tyre.

Ashtu siç thekson prof.Ibrahimi se “Gjuha e autorit Murat Isakut studiohet edhe në dritën e raportit të tij me etnosin, gjegjësisht me kulturën materiale dhe shpirtërore, mentalitetin dhe krijimtarinë popullore të atij etnosi, që mund të jetë edhe në kompetencat e *gjuhësisë antropologjike, antropologjisë kulturore, sociogjuhësisë, psikologjisë sociale, kulturologjisë* ose fushave tjera interdisiplinare. Pikërisht në veprën “Rrengu” të Murat Isakut, në vija të përgjithshme përfshihen marrëdhëniet midis etnosit dhe gjuhës bazuar në hipoteza që ndikon në gjuhën dhe të menduarit e njerëzve. Në brendinë e kësaj vepre janë regjistruar edhe biseda të ndryshme popullore dhe materiale tjera dialektore, me çka kësaj vepre i jepet një dimension të ri folklorik dhe kulturor. Këtu kemi të bëjmë me kulturën e etnosit shqiptarë, por jo duke u mbështetur në kulturën elite, por në kulturën popullore dhe tradicionale siç janë: *biseda të përditshme, histori, rrëfime të jetës, punë të ndryshme, kujtimet si këngë, përralla, proverba, poezi* dhe çdo tekst tjetër dialektor dhe folklorik që kishin në dispozicion, si *përshëndetjet, doket, zakonet, traditat, ritualet, magjitë, syri i keq, urimet, mallkimet, traditat dasmore, lindja, vdekja etj.* Hulumtohen edhe aspekte të tjera të kulturës tradicionale si: *meteorologjia nacionale, mjekësia, mjekësia veterinare, bindjet për kafshë, etj.*” (Ibrahimi 2016:109).

Në këtë shqyrtim të studimit etnolinguistik të veprës “Rengu” të Murat Isakut, na ndihmoi shumë artikulli “*Vështrime etnolinguistike në romanin “Rrengu” të Murat Isakut*, nga studiuesi prof.dr. Mustafa Ibrahim, të botuar në përmbledhjen e kumtesave nga Konferenca shkencore “*Veprimtaria letrare e Murat Isakut dhe Abdylazis Islamit*”, të botuar në vitin 2016 nga UEJL, Tetovë. Ne kemi marrë parasysh të gjitha këto ndarje strukturore të studimit etnolinguistik të veprave të Murat Isakut, duke bërë një strukturë të veçantë të analizimit të veprave të Murat Isakut dhe duke i krahasuar me veprat e tjera të tij.

1. Shqyrtime etnokulturore

a) Përdorimi i nofkave

Pothuaj në të gjitha veprat, e në veçanti në romanin “Rrengu” shkrimtari Murat Isaku ka përdorur me xhelozi edhe nofkat si dëshmi të moçme për kulturën, gjuhën dhe trashëgiminë shqiptare në përgjithësi. Të dhënat e mbledhura nga ky roman mbështesin e faktojnë edhe më tej konstatimin se nofkat ashtu si emrat e moçëm familjarë që përdorin shqiptarët e Maqedonisë, hyjnë në sistemin e shqipes së përbashkët”. (Ibrahimi 2016:110)

Nofkat e mbledhura në romanin “Rrengu” të Murat Isakut janë këto: Heqlaplluqi, Gungaçi, Kokëderri, Xhenazja nr.17, Yll i larë i mirësisë, Kriminel i dyfishtë (Xhelal Preja i burgosur, ndryshe thirreshte me këtë nofkë), Çapaçuli (kjo nofkë ishte për gardianin e burgut që ia kishin vendosur të burgosurit), Duhaxhiu (një i burgosur i ri), Daci, Kali i shkretëtirës (kështu e quante vetveten prijësi i karvanit), Zog Petriti, Brizani i shtatë luftrave midis tre deteve (kjo nofkë ishte për Metë Prokshin) , Ezmerja (Emri saj ishte Feride , njiheshte si fallxhore) , Trokashkë ndryshe “mulli pa drithë” (nofkë për Sheh Sediut që ia kishte vendosur baba Qamë), Beronjë (kjo nofkë ishte për Sheqiben e ustabash Kadriut, këtë emër e kishte marrë sepse kishte mbetur barkthatë, kështu shpjegohet në roman, Peshkaqeni dhe Krokodili (këto nofka janë për Kasum Sahitin), xhuxhmaxhuxhi Gjyzelevlad, Sheqerlievrad (këto nofka janë për Ajshen), Ushtari betejës së humbur, Ylli mbi mal .

b) Përdorimi i eufemizmave

Si strategji të rëndësishme, ta quajmë etnolinguistike, autori Murat Isaku në romanin e tij përdor edhe eufemizmat, sepse gjuha pa eufemizma paraqet një mjet të dobët komunikimi. Pikërisht ky mjet është shumë i fuqishëm në këtë veprë. (Ibrahimi 2016:2010). Profesor Ibrahimi, krejtësisht ka pasur të drejtë të vlerësojë se Murat Isaku në veprat e tij na jep shumë eufemizma për emërtimin e shumë objekteve dhe tempujve, por edhe të burgosurve dhe autoriteteve të burgut.

Eufemizmat e mbledhura në romanin “Rrengu” të Murat Isakut janë këto: *Gryka e Gjarpërit*, *Fajtorë të Zandanit*, *Bitisxhane*, *Xhenaze*, *Mulliri i Shkretëtirës*, *Xhenazja numër shtatëmbëdhjetë*, *Truqethurët e dhunës*, *Hijerëndë i fyer*, *buzaç*, *kokëshinik*, *Telashexhinj*, *Zorra e trashë*, *E bukura e dheut*, *I pagoji*, *hundëshkabë*, *picigjatë*, *dhëmbërënë*, *ballëbullungë*, *mjekërgjatë*.

c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse

Gjatë analizës së romanit “Rrengu” të Murat Isakut arrijmë të gjejmë edhe emra përkëdhelës, që në fjalor na jep këto shpjegime: 1. që përkëdhel; që shpreh dashuri a ëmbëlsi; i këndshëm; ledhatues: shikim përkëdhelës; fjalë përkëdhelëse. 2. *gjuh.* që ka ngjyrim zbutës a mirëdashës; që me trajtën e vet shpreh përkëdhelje a zbulim: emër përkëdhelës; prapashtesë përkëdhelëse.

Në veprën “Rrengu” arritëm t’i gjejmë këto : *Qofsh ti shëndosh e mirë*, *Zoti është i Madh*, *Ia puthsha syrin*, *Ruaje për faqe të bardhë e ditë të zezë*. Nga fjalët përkëdhelëse më shumë përdoren: *Mirosh dhe vëllaçko*.

ç) Përdorimi i mallkimeve popullore

Perkrah kulturës dhe traditës, shkrimtari Murat Isaku, në veprat e tij ka përdorur edhe mallkimet. Këto janë forma të të shprehurit të inatit, zemërimit të cilat gjejnë përdorim në të folurën popullore të përditshme. Gjatë analizës së romanit “Rrengu” të Murat Isakut arritëm t’i gjejmë këto mallkime popullore: *Këput kryet!*, *Mortja e marrtë!*, *E thefsh qafën!*, *Na piu e zeza!*, *The qafën!*, *E faroftë mortja!*, *I raftë nama!*

d) Përdorimi i ngushëllimeve

Autori Murat Isaku, në veprat e tij ka përdorur edhe ngushëllime me të cilat përmes fjalëve ka shprehur dhimbjen e vdekjes. Ai ka ditur kulturën e vendasve dhe ka përdorur shprehje me të cilat na mëson se si ta respektojmë të vdekurin, por përmes fjalëve. Se a ekziston kultura e duhur

gjuhësore ndër ne në një rast të tillë? Autori ka përdorur edhe ngushëllime për të lënë gjurmë edhe në këtë pjesë të trashëgimisë sonë kulturore.

Gjatë analizës së romanit “Rrengu” të Murat Isakut arritëm t’i gjejmë këto ngushëllime që shprehen më shumë: *Rahmet ! , Rahmet atij trualli! , Rahmet pastë, Rahmet e Xhenet , Amin!*

e) Ofendimet (sharrjet)

Përdorimi i gjuhës fyese, shantazhet, kërcënimet, përçmimet etj. kanë qenë të pranishme edhe në jetën e përditshme të popullit tonë me shekuj. Shkrimtarët shpesh në veprat e tyre kanë përdorur edhe ofendime për ta reflektuar më mirë gjuhën e popullit por edhe për t’i dokumentuar ata. Në veprat e tij, Murat Isaku ka përfshirë shumë ofendime.

Gjatë analizës së romanit “Rrengu” të Murat Isakut arritëm t’i gjejmë këto ofendime (sharrje): *Shtrigë bishtderdhur, shtriga, kopuk, guc i thiut, qen, teveqel, qafir, Kodosh i motit , Pis i mutit, ta kalarofsha dadën mu në...! , T’u thaftë kodosh! , Ta shkërdhefsha vdekjen tënde !, Pis, Tutkun, Pordhavec i Lalit, Coftinë, Or pirishan, I Trentë, Perishan, Tru thatë, Ore ti farë kakavani, Or qeros qibari, Kakavani , Derr i egër , Bythçjerrët.*

2. Shqyrtime onomastike

Onomastika si degë e gjuhësisë, që studion emrat e përveçëm; pjesë e kësaj dege që studion emrat vetjakë (emrat e mbiemrat e njerëzve, si edhe nofkat e njerëzve e të kafshëve). Ajo përfshinë dy fusha kryesore: toponiminë dhe antroponiminë. Onomastika shqiptare ndihmon për sqarimin e mjaft çështjeve nga fusha e historisë së shqiptarëve, e arkeologjisë, e etnografisë, e folklorit, e gjeografisë etj. si në rrafshin historik ashtu edhe në rrafshin bashkëkohor. Para Çlirimit, disa autorë të huaj, edhe ndonjë vendës janë marrë me mbledhje e botime materiale kryesisht nga fusha e toponomastikës. Pas Çlirimit kërkimet onomastike u vunë mbi baza shkencore të organizuara. Pranë disa sektorëve të shkencave shoqërore u ngritën edhe kartotekat e para të onomastikës shqiptare. Autori Murat Isaku, kësaj dege gjuhësore i jep një rëndësi të veçantë duke na ofruar shumë shembuj. Kështu në romanin “Rrengu” janë përfshirë emra të viseve të cilat quhen ndryshe toponime, emra të njerëzve të cilat quhen ndryshe antroponime dhe emra familjarë që ndryshe quhen patronime .

a) Emrat e banimit dhe tempujve

Emrat e banimit dhe tempujve që kemi arritur të gjemë në romanin “Rrengu” janë këto: *Xhan Insan Mybarek Baba, Kroi i Tempullit, Lumi i Varrosur, Kroi Hanit Mullar, Lumi i Kasabasë, Xhamia e Sahatit, Eskixhamia, Mëhalla e Hamamit, Çarshia e Vjetër, Lagja e Epërme, Udhët e Jemenit, Tempulli Halveti, Lugjet e Gjata, Pronat e Matanë Lumnës, etj.*

b) Emrat dhe mbiemrat si shenjë indentiteti

Në këtë roman kemi shumë emërtime si emra vetjake, emra të vjetër, emra fetarë, emra historik. Po mund të themi se në romanin “Rrengu” të Murat Isakut mbizotërojnë emrat e huazuara laikë dhe fetarë, mund të themi se shumë pak janë të pranishëm emrat me burime vendase. Emrat që kemi mbledhur janë këto: *Xhelal Preja, Abu Xhabir, Kara Hasani, Lazam Qeli, Haxhi Efendi Mulla Sabiti, Plep Krasta, Baba Qamë, Metë Prokshi, Metë Brizani, Gjylshahe, Feride, Kyçyk Hoxha, Sheh Sadiu, Sheh Xheladini, Kalif Saabiu, Afsha, Mulla Ibrahim Efendiu, Ajshe, Sheqibe, Usta Tuka, Gjergj Elez Alija, Daci, Paci, Laci, Hasan Delia, Nurshendi, Kasum Sahiti, Nazari, Vahide, Selim Beu, Rexhepi, Xhabiri, Xhevdeti, Shehledini, Xhemali, Xhaferi, Xhumleti, Gjergj Elez Alia, etj.*

c) Emra kafshësh

Në romanin “Rrengu” të Murat Isakut kemi arritur të gjejmë këto emra kafshësh: Dhia Belegën Kërrutë – pasi iu thyen brinjët në Rëmore ia shtuan llogapin *Kërrutë*, më pas kemi *Kuqoja* dhe *Murroja* (dy që që heqin qerren).

3. Shqyrtime leksikologjike

a) Pasqyrimi i fjalëve të urta

Proverbat janë fraza të shkurtëra që shprehim me pak fjalë filozofinë popullore (urtinë popullore). Pikërisht për këtë, ato thirren nga populli edhe fjalë të urta. Proverbat janë të përhapur në të gjithë botën dhe nuk ka dyshim se midis tyre hasen edhe ngjashmëri apo identitete. Megjithatë, çdo popull ka proverbat e tij, të ndërtuara sipas psikologjisë dhe përvojës së tij jetësore, filozofike e historike. Nganjëherë është e lehtë të caktohet pak a shumë një moshë për një

proverb të caktuar, por në më të shumtën është e vështirë aq më tepër që në rrymë të kohës, proverbat edhe evoluojnë e mund të marrin edhe trajta disi të ndryshme.

Te romani “Rrengu” të Murat Isakut hasen shumë fjalë të urta, si: *Ruaje për faqe të bardhë e ditë të zezë, Gurët nuk ikin nga toka, njësoj si mëkatet nga mishi, E ka hëngër koha, S'bie rrufeja në hidhëra, Ku rafsha mos u vrafsha, Do të shkoje koka dushk për gogla, Ç'i bën dhia shqemes, shqemja ia bën lëkurës, Zogu te druri, miku te miku, Për din e për iman, Shpirtin e ka jallan, mendjen biftan, Jeta dushk për gogla, Pyka nxirret me pykë, vrasja lahet me vrasje, Ti hem qeros, hem qibar, Ujku e ka qafën e trashë, ndaj i kryen punët vetë, Zhapiu i tempullit me lug të kon me bisht të verbon, Gurët nuk ikin nga toka njësoj si mëkatet nga mishi, Aty ku s'ka emër, s'mund të ketë as drejtësi edhe pse mund të nxirren ligje të mëdha, Askund s'do gjesh një botë aq të madhe prej nga do të mund t'i nxjerrish të gjitha rrënjët e jetës tënde, Aty s'mund të ketë lumturi, sepse s'ka mendje të pastër dhe shpirt të lirë, Shpirti i mashtruar i takon djallit, Midis territ dhe shpirtit gjendet një kufi, të cilin s'mund ta kapërcejë secili.*

b) Pasqyrimi i njësive frazeologjike

Frazeologjia si degë e leksikologjisë studion bashkimet leksiko-semantike të fjalëve dhe tërësinë (fondin) e njësive frazeologjike të një gjuhe të caktuar. *Njësia frazeologjike si njësi gjuhësore me kuptim të mëvetësishëm, e përbërë nga dy ose më shumë fjalë shënjuese (emërtuese), me gjymtyrë e ndërtim të qëndrueshëm, e formuar historikisht e për një kohë të gjatë, që ka vlerën e një fjale tëvetme, riprodhohet në ligjërim si njësi e gatshme dhe funksionon në gjuhë si njësi e pandashme* e hasim edhe në veprat e Murat Isakut.

Në romanin “Rrengu” të Murat Isakut kemi një numër të madh të njësive frazeologjike: *Pordhi kali në derë të hanit; Daci im qerrata të ka ecur si shelgut, Mashalla; Pordha jote, shih tra e bën konak; Të rroftë magari që ka cofur; I kishte rënë pika në zemër; Hajgare pa kripë; S'ta shpëtova jetën për sytë e zezë; Pa kokërr fryme në gojë; Kush thumbit e kush patkoit; Në bluante në bark; Si kërpudha pas shiut; Botë pa gojë; S'pret spata nga të dy anët; Varret s'kanë tapi; Ia nxori bishtin; Okën pije, pikën mos e derdh; U bë deti kos!; Nga bishti qelbës, nga turinjte trumhos!; Hëngër fiq e vdiq; Kulla do mysafir; U korre ku s'u mbole; Pasi u del fryma nga goja si pordha nga bytha, i ha i njëjti krimb – krimb i shkretëtirës sonë; Dielli u bë flakë.*

c) Pasqyrimi i neologjizmave

Neologjizmat janë formuar gjatë historisë së gjuhës me anë përkthimit prej gjuhëve të tjera. Me industrializimin e vendit, gjuha, duke u modernizuar, humbet në mënyrë të pazëvendësueshme vazhdimisht një pjesë të elementeve të leksikut të saj. Sipas Çabejt, kjo detyrë duhet të ndërmerret me një plan pune të caktuar mirë dhe të kryhet në mënyrë sistematike, duke sugjeruar një pastrim nga elementet e huaja që po vërshojnë në gjuhë prej të gjitha anëve. Neologjizmat që gjetëm në romanin “Rrengu” janë: Huajinë – për diçka që është e huaj, agimin për agun, lythrak për i lythtë , kepishte për vend me kepa (shkëmbinjë) , therrtar për kasap; gurrëvarrezë , fatprerë , fatkob.

ç) Pasqyrimi i dialektizmave

Dialektizmat janë fjalë të cilat janë përdorur në të gjitha veprat e shkrimtarit edhe këtu kemi arritur të gjejmë fjalë dialektore si: *Shpi* , *kthy* , *etj*.

d) Pasqyrimi i arkaizmave

Arkaizmat janë objekt i rëndësishëm studimi sepse janë studiuar vetëm në ligjërimin e përditshëm letrar e bisedimor. Në romanin “Rrengu” arritëm t’i gjejmë këto arkaizma : *Okë* - (kilogram) okë qystek në gjoks, *Zandan* (bitucë), *kleçkë* (rreng), *kaci* (lloj mjeti pune) .

Fjalë pasive : *ndofta* , *sofra* , *etj*,

e) Pasqyrimi i historizmave

Historizmat janë përdorur në një periudhë të caktuar kohore dhe sot hasen kryesisht në letërsi ose në veprat shkencore që flasin për atë periudhë si psh : *çanakë*, *dzytaban* , *etj*,

f) Pasqyrim i huazimeve

Huazimet nuk mungojnë asnjëherë në veprat letrare në përgjithësi, e veçanërisht në veprat e autorit, ku kemi arritur të mbledhim një numër të konsiderueshëm të fjalëve të huaja, që shumica janë turke : *ahiret* , *istikam* , *hamam* , *papepur* , *bimbash* , *rradake* , *reqatë* , *namaz*, *këna* , *han* , *bahçe* , *ilet* , *nalet*, *heqim* , *derman* , *ugrak* , *kasaba* , *mihane* , *avlli* , *bazhdar* , *askeri* , *sarhosh* , *sevda*, *sajdis* , *çarshi* , *gazep*, *mereqep* , *karasevdali* , *kobure* , *hapsanexhi* , *ujë zemzemi* , *bandilla* , *mesele* , *sallhane* , *sahat* , *ezan* , *namaz*, *shehadet* , *qefin* , *minaret* , *ustabash* , *silah* , *karabinë* , *dushman* , *mëhallë* , *ustallarë* , *shahitë* , *sahatkullë* , *xhenet* , *nizamë* , *karamanjollë* , *kapixhik* , *nur* , *katikule* , *kasaveti* , *jangllësha* , *haber* , *temena* , *jallan* , *biftan* , *arpallëk* , *çarçaf* , *namuz*.

4. Shqyrtime folklorike

Në romanin “Rrengu” të Murat Isakut ofrohen shembuj nga fusha e folklorit. Kemi këngët që këndohen, baladat shqiptare, instrumentet.

1. Titujt e këngëve dhe këngët që i hasim janë: “Shkojnë e vijnë pampurat nuk na i kthejnë nizamët”, “Po shkojnë pampurat , moj nëno” , “Ktheja nishanin nuses nëno!” , “Sonte është natë e madhe, natë e halvetinjve, ndofta gjëkund hahet syfyri , ndofta”

2. Instrumentet që përmenden: dajrja, daullja, zurlja, legeni, duduku, darabuka, tamburaja, zamarja;

3. Balada shqiptare: “Ajo ka vdekë e ka marrue “

VEPRA 2

Romani “GËRSHETAT”

Vendlindja konceptohet si lidhje ekzistenciale me tokën, me traditën, me familjen, si evokim, ikje nga përditshmëria, kthimi në fëmijëri apo kërkimi i një parajse të humbur ku ruhen kujtimet e fëmijërisë. Në veprën e tij “Gërshetat”, Murat Isaku trajton disa tema që mbesin të përhershme në gjithë krijimtarinë e tij letrare. Kryesisht trajton tema shoqërore dhe dramet e njeriut në të kaluarën dhe të tashmen. Gjithashtu janë prezente edhe temat e luftës, burgut, temat e tokës, e mbrojtjes së saj, ruajtjes së identitetit, tema e familjes dhe bashkësisë si institucione fisnore dhe shtylla të krijimit të raporteve mbrenda njerëzore. Murat Isaku është shumë i lidhur me vendlindjen e tij fshatin Gajre, ashtu sikur Ismail Kadare me qytetin e Gjirokastrës dhe që të dy trajtojnë gati tema të njëjta të vendlindjes së tyre.

Personazhëve kryesor në këtë vepër do t’u bëhen shumë padrejtësi. Do t’i akuzojnë për vrasje, do t’i shpallin si të vdekur edhe pse ata jetojnë ende. Në veprën “Gërshetat”, po ashtu edhe në veprat e tjera të tij, Murat Isaku e ka paraqitur mjeshtërisht njeriun e ambientit të Pollogut dhe Sharrit, me të gjithë karakteristikat e tij etnopsikologjike dhe transformimet shpirtërore, gjatë përpjekjeve të tij për mbijetesë. Ky njeri mbetet figura qendrore e kësaj krijimtarije letrare. Janë për t’u veçuar edhe përshkrimet e po këtij ambienti, paraqitja artistike e karakteristikave gjeografike, kulturore dhe etnolinguistike.

Hapësira e vendlindjes është dominuese në këtë vepër edhe kur shkrimtari krijon emra imagjinar toponimesh.

Të gjitha emërtimet dhe pseudonimet që i ka bërë autori në veprën e tij “Gërshetat” dhe në veprat e tjera të tij, janë të bazuara në karakterin e personazhëve. Emërtimet e personazhëve i ka bërë në bazë të vendeve në të cilat është zhvilluar ngjarja, duke mos përdorur emra të huazuara nga gjuhët e tjera të cilat nuk kanë domethënie dhe kuptim në gjuhën shqipe.

Në romane ku ngjarja zhvendoset në ambiente më të largëta, sërisht ambienti dominues mbetet vendlindja e autorit (f. Gajre). Kjo vërehet nga përshkrimet e peizazheve, vendeve rurale dhe urbane, karaktereve të njerëzve, psikologjia e tyre, ritet dhe ritualet, e folura, mitet, para së gjithash frazeologjia popullore, e cila është tejet e shprehur qoftë në rrëfimet ose në të folurën e personazhëve.

1. Shqyrtime etnokulturore

a. Përdorimi i nofkave

Murat Isaku ka përdorur nofkat si dëshmi të moçme për kulturën, gjuhën dhe trashëgiminë shqiptare, si në të gjithë veprat e tjera edhe në veprën “Gërshetat”, ai ka përdorur nofka, ne kemi arritur të gjejmë disa prej tyre si:

Njeriu me uniformë të zezë, Qel Qulahu, Sharrjani, Sali Shkëmbi, Xhelë Gungaçi, Gungaq-pupërdhaqi, Brunetka, Zgabelli, Çirçikla, Zot i Sharrit, Tagërmbledhësi, Çalamani, Zonja Rezedritë, I ndjeri, Njeriu shend e verë.

b. Përdorimi i eufemizmave

Eufemizmat e mbledhura në romanin “Gërshetat” të Murat Isakut janë këto: *I mori ferrat. Hëngri me sy gjykatësin. M'i ka tharrë moti krahët. Çere varri (fytyra i mori ngjyrë). Brita kupakresë. M'i kridhte duart në gji. Kalonim mjaltë e sheqer. (Mirë). I çilej moti mbi ballë. Tufka kujtimesh. Shaliri vështrimin. Qeshi ndërhundë. Vrau sa vrau mendjen. Theu mendimin. Foli me gjak të ndezur. Rahi ballin. Shtrëngoi zemrën. Ia piu mendjen. I qeshi fytyra.*

c. Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse

Në këtë vepër nuk mungojnë as urimet dhe fjalët përkëdhelëse, të cilat prindërit ua thonin fëmijëve të tyre kryesisht gjinisë mashkullore që të bëheshin të fortë dhe trima.

Urimet që i ka përdorur autori në këtë vepër janë:

Rroftë, Mashalla, mos na marrtë syri i keq; Të pastë babai dragua; Juve tul e dhjam, e vëllait tim rahmet e xhenet; “M'u bëfsh sa lisi i Elmazit”; Ma ke atë shtat si plep; Ç'do boijë thauoj shpirtkë.(Shpirtkë); Dashi i babait.

d. Përdorimi i mallkimeve popullore

Në vepër janë prezente edhe mallkimet, të cilat M. Isaku i ka përdorur kundër njerëzve të cilët i nëpërkëmbnin interesat e popullit shqiptar. Gjithmonë në vepër vuanin njerëzit që kanë qëllime të mira për popullin dhe vendlindjen e tyre. I tillë ishte autori, i cili gjithnjë e dëshironte të drejtën dhe të mirën e popullit të tij. Disa nga këto mallkime që ka përdorur ai janë:

Mallkuar, mallkuar! Ju preftë ujku! Ju hëngërt frëngjuza! T'i sostë miu i drithit mendët, U marroftë Zoti. Kafshatë dreqi, kriminel.

e. Përdorimi i ngushëllimeve

Ngushëllimet janë pjesë e kësaj vepre, mirëpo të pakta në numër, ato të cilat i kemi hasur gjatë të lexuarit të veprës janë këto si:

Ndjesë pastë! Rahmet pastë!

f. Ofendimet (sharjet)

Në çdo vepër të M. Isakut pjesë e pa ndarë e rrëfimit të tij janë edhe ofendimet. Këta ofendime ai i ka bërë kundër njerëzve të cilët nuk ia donin të mirën popullit shqipëtar. Gjithmonë ishte i revoltuar ndaj këtyre shtresave të njerëzve. Njeriu i cili ka ideale të larta në jetë gjithmonë bëhet viktimë e njerëzve të padrejtë, të korruptuarve. Prandaj nuk është e rastit që në përgjithësi te veprat e tij kemi një numër të madh të ofendimeve. Ofendimet që janë gjetur në këtë vepër janë:

Uh, nënën e nënës! Tëhu jazëk! Se dreqi i zi të ha, kurvë, he nënën tënde! Or kal i botës or çalaman! Mos ma përmend Majën se dreqi i zi të ha, kurvë, he nënën tënde! Kudër!

e. Betimet

Në këtë vepër nuk mungojnë as edhe betimet, të cilat kanë qenë pjesë e pandarë e personazhëve të krijuar nga autori. Ato janë:

Për Zo! Pasha Zotin! Vetëm kur të fiket me njeri e gjëri shtëpia e Qel Qulah sharjanit! Mos të qofsha falë, Vallahi bilahi, për Zotin, pasha bukën. Vetëm zemrën e pranoj gjykatës hë!

2. Shqyrtime onomastike

a. Emrat e banimit dhe tempujve

Murat Isaku ishte i lidhur shumë ngushtë me vendlindjen e tij fshatin Gajre. Ai ka paraqitur shumë emra të vërtetë të vendlindjes së tij dhe qytetit në të cilin ka jetuar. Preokupimi kryesor i historisë së jetës së tij kanë qenë kalaja e Tetovës, Teqeja dhe veçanërisht toka e Gajres. Në vepër ka paraqitur disa emra të banimeve dhe tempujve që janë të vërtetë. Disa nga këto emra që i ka përdorur janë:

Romës, Lisbonit, Tetovë, Banovinë, Sharri, Kështjella e Rozafatit, Kroi i Shtegëtarëve, Vietnam, Bregdeti Adriatik, Turqi, Te guri i hashures, Bagdad, Rruga e dy plepave. Rruga e dy rrugëkryqeve, Kështjella e Rozafatit. Kalaja,

b. Emrat dhe mbiemrat si shenjë identiteti

Në të gjitha veprat e tij në prozë dhe tregime si pikë kryesore e rrëfimeve të veprave të tij kanë qenë Sharri dhe personazhët sharrian. Personazhët janë real dhe të imagjinuar. Kategori tjetër e njerëzve që ka paraqitur ai janë spiunët, tradhëtarët, udbashët, njerëzit të cilët e bënë dhunën mbi të burgosurit. Këta njerëz janë kategoria më e fëlliqur, kategoria manipuluese që paguheshin për një shërbim. Vetë autori ishte pre e një politike sllave që bëhej ndaj shqiptarëve. Disa nga emrat që na i ka paraqitur M. Isaku në veprën “Gërshetat” janë: *Hasan Predha, Besnik Lokaj, Maja, Nazlije Sana, Ibish Ibrahimini, Elita, Sanije Sana, Kurtish Qana, Hajdar Drini, Boshko Petroviq, Kadri Hani, Xha Tahiri, Hana, Elmazi, Rasimi, Kamberi, Xha Kasami, Qazim Qela, Xhafer Beu, Suat Beu, Hasan Beu, Ali Pashë Tepelena, Timur Lengu, Adem Preka, Kumrije Preka, Tre kollxhintë me armë, Sali Shkëmbi, Martiri, etj.*

c. Emra kafshësh

Nuk mungojnë edhe disa nga emrat e kafshëve, të cilat autori i ka paraqitur në vepër. Qeni i malësisë së Sharrit (Qen Sharri) është lloji i racës së qenëve që ishte i lidhur ngushtë me jetën e fshatarëve. Ai ishte pjesë e pandarë e jetës së tyre, ishte ai i cili kujdesej për shtëpinë dhe bagëtitë e tyre kur ata i sulmonin kafshët e egra por edhe njerëzit e këqinj. Emrat e kafshëve që hasen në vepër janë disa qen si:

Gafrona (qen), Karabashi, Kulo, Qeni i shtëpisë numër njëzet e pesë, kali Gjok.

3. Shqyrtime leksikologjike

a. Pasqyrimi i fjalëve të urta

Jeta është një këmishë që s'i përngjet asnjë mode. I shkante gjuha ku i dhemb dhëmbi. Çdo fillim nis si një përrallë dhe çdo mbarim i shëmbëllen një udhëtimi. Shtëpia pa tym, vija pa lymë. Sa ka ujë deti aq ne kemi kujtime të ëmbla. A mund të ndahet mishi prej thoit. Secilit gur Zoti ia ka falur shtratin e vet dhe secilit dru rrënjën e vet. Vdekja e vërtet është njësoj për të gjithë, por secili vdes në mënyrën e vet. Mendja e njeriut duhet të kositet jo dy herë si livadhet, por edhe tri herë. Toka është njësoj ndryshojnë vetëm vdekjet.

Çdo kujtim është një gur në muret e jetës. Edhe të gjallët edhe të vdekurit i kujtojnë në heshtje s'ka fund 'ska. Ajo është një ujë që ecën prorre në tokë, të gjithë e dinë, po askush s'e sheh. Kush mund të thotë se edhe vdekja është një copëz jetë? A s'është jeta e tyre një durim madhështor, që habit edhe mrekullon! Si mund ta quajsh kohën e të vdekurit nën tokë, i cili kurrë nuk reagon në gabimet e të gjallëve edhe pse s'i nxe asnjë thes prej najlloni? Ç do i gjallë është edhe përgjysëm i vdekur. Asnjëherë vdekja s'falet për kujtim dhe varri nuk shitet. Në varr nuk shkruhet historia, po harrohet. Njeriun s'e bën të madh varri, po vepra, hë!

b. Pasqyrimi i njësive frazeologjike

Populli ynë dallohet për shumë tradita të trashëguara brez pas brezi, ku përmes frazeologjisë jepet tradita e popullit tonë, identiteti, mendësia, besimi, karakteri dhe psikologjia e tij. Vepra e Murat Isakut "Gërshetat", është shumë e pasur me njësi frazeologjike, të cilat shprehin kuptime të ndryshme. Disa nga këto njësi frazeologjike janë:

A mund të ndahet mishi prej kocit?! Sa çel e mbyll sytë, Trimi me shtatë zemra, Ec e zërja me gojë E hëngri me sy, Që ta nxirnin në dritë, Këtë që po thot avokatja e re se duron as përralla, Përpiqej t'i jepte udhë tërë këtij pështjellimi, Nuk pat zemër të butë, Shkyheshim gazit, Si kishte mbetur pikë gjaku në fytyrë, Fjalët ngrinë mes dhëmbëve, Edhë plumbi t'ia shponte shtatin, nuk do t'i pikonte pikëz gjaku, E shtynim jetën si gjarpri nën gurë, Lulet e kumbullave kishin veshur fshatin, Diç na përvloi shpirtin, Fytyra iu bë uthull, Si tia lidhim kryet punës? Gjumin e kish si një lepur. , Kur i hipte damari. I është zbutur damari, U shkante vala, Ta thej këmbën e shejtanit, Kur i prishej gjaku, Kalonim mjaltë e sheqer, Mbushim uj me shoshë, fola hundë e buzë, Per majë të gjilpërës, Mua akoma nuk mi ka pirë miu i drithit mendët e kresë, Ish e kotë të rahim uj në havan, Shpirtin në fyt, Sa çel e mbyll sytë, Rritnin inatin si thundrat e gomarit, Verte i ishe pjekur ylli i martesës. Si të vrarë!, Do ta luaja gishtin! Na i zen këmbët, Nuk më zente vendi vend, Më lëshonte trolli, I plasi zemra, I vuri kyç gojës, S'na ka mbetur në lugë uji i turbullt, nuk më ka mbetur ujë

në sy (S'kam asgjë), I kërceu damari permbi vetull. Dielli sharronte. Ia pastronte oxhaqet e zemrës. U zhduk pa nam e nishan. S'i kish mbetur pikë gjaku në fytyrë. Fjalët ngrinë mes dhëmbëve. Të pesë fëmijët e shtypnin jetën si gjarpëri nën gurë. Qeni llapërçitej. Si mund të flente gjyshi kaq rëndë kur gjumin e kishte si një lepur. Buzët e pjekura nga dielli i verës. I është zbutur damari. U rritej inati si brirët e dashit. Ah sikur t'i hajë goja mjaltë.

Duhani është bërë për t'ia thyer kopilat, kurse gruri i arës së dytë, po qan për drapër. Ia plasi gazit me loçkën e zemrës. Dielli i verës ia mori gjysmën e fytyrës. Kur bën të qeshësh të hahet goja e kur bën të qash, të sosen sytë. E vështroi mu në ninëz, aty ku lexohet dyshimi. Hante me bisht të syrit harqet e mureve.

c. Pasqyrimi i neologjizmave

Neologjizmat që na paraqiten te “Gërshetat” janë: *kaqitq, leshtuke, qelbosje, shprishura, shkëmbosur, njëshkolonë, mëkatos, harenxitëse, vegimthi, hutimthi, një kaqitq, ëndërralla, fluturimthi, mesoburre, kupakresë, gojaplot, ballaballës, vetëtimthi.*

d. Pasqyrimi i dialektizmave

Murat Isaku nuk ka harruar edhe të folmen e vendlindjes së tij të fshatit Gajre, ku në këtë vepër ka futur edhe shumë dialektizma siç janë: *Femijëni, kthy, djegjën, paqtë, ftekej, bojë, maqinë, penguloi, drizë, pingël, furrik, thauoj, fteket (kujtohet), u kthy, gjejshim, djegjën, fitilaqi, përroi, gjeremi, maur, blaur, pllogët, trrolli, megje, shatiçe (vegël pune – shati), thaujse, suall, etj.*

e. Pasqyrimi i arkaizmave

Në vepër ekziston edhe përdorimi i arkaizmave, ne arritëm të gjejmë disa prej tyre: *okë, manzeren, govatë, vatër, carrokë, vrinkth, manzerë, opinga, vadijtje, mylk, argatë, llullë, qerre, ibriku, etj.*

fjale pasive : *Ndofta, magjes, saçit, çerepit, kusi, pojatë, mashën, sofër, vatrës, opingat, palarenë, çerep, skutaqe, ojme, magje, hambarë, etj.*

f. Pasqyrimi i historizmave

Ne veprat e tij nuk mungojnë edhe përdorimi i historizmave, siç kemi hasur historizmat: *Partizanët e plagosur, korjeri i çetës, partizanë, dyqind banka, tagramledhësi, dinar, pîrg, vig, partizançe, decenieve, njëqind banka, traketruqe, dy dinar, timarhane, Lufta e Dytë Botërore, çiflig etj.*

g. Pasqyrimi i huazimeve

Në gjuhën shqipe shumë fjalë kanë hyrë në të folurën dhe të shkruarën gjatë shekullit XV, siç dihet kur Shqipërinë e pushtoi pesë shekuj me radhë pushtuesi osman. Gjurmët e këtij pushtimi mbetën edhe në gjuhë. Huazimet që na paraqiten te kjo vepër janë kryesisht ato turke si: *Karabojë, katran, bojën, açiku, hajat, sokak, mavi, parmakë, sahani, dëmkën, silla, nafakë, haram, sandëk, çardak, hajvan, sade, sabah, bereqet, sofër, çanakë, synet, sherjat, hesap, borxh, karshi, pazartllëk, çejez, tefteri, bohçe, çajxhahane, hamam, rremeti, jevgjite, kapotë, kokërdhokë, jeshile, derman, delikte, sahan, menze, dukat, dëmkën, pojatë, mashën, sofër, magje, setër, haram, caranik, sabah, megje, terezi bereqet, saç, reçel, çanakë, tepsi, kusi, mësallë, avaz, ahur, çerep, kapuç, mashalla, belaxhinj, marhamë, dukat, kapixhiqet, beu, çibuk.*

Salutoi – nga frengjishtja *salut* – *përshëndetje*.

Internacionale: *byro, klient, decenie, akoma, demobilizove, improvizuar*

4. .Shqyrtime folklorike

Burim frymëzimi i çdo autori shqiptar për të shkruar dhe krijuar qoftë një poezi, tregim ose vepër, padyshim ishte letërsia popullore. Në romanin “Gërshetat” të Murat Isakut ofrohen shembuj nga fusha e folklorit . Kemi këngët që këndohen , baladat shqiptare dhe instrumentet.

1. Instrumentet muzikore që përmenden në këtë vepër janë kryesisht *lahuta, qiftelia, dajreja* dhe *fyelli*. Nuk mungojnë edhe veshjet popullore si: *tirqit, qeleshe* etj.

2. Tituj të këngëve dhe këngët që i hasim janë: “*Matanë bregut e matanë detit*”, janë kënduar edhe këngë epike. Përveç këtyre këngëve kemi edhe festat pagane si “*Dita e shëngjergjit*”, “*Dita e luleve*”. Në vepër gjithashtu hasen edhe legjendat si ajo arabe “*Një mijë e një net*”, “*Kështjella e Rozafatit*” dhe “*Kali i Trojës*”.

VEPRA 3

Romani “FATPRERËT”

Murat Isaku te vepra e tij “Fatprerët” trajton tema nga e kaluara, por që janë tejet aktuale për ditët tona, edhe këtu kthehet te fatkeqësitë tona të shumta. Sikurse në të gjitha veprat e tij edhe në romanet e më vonshme ngjarjet zhvillohen mbi një galeri personazhesh të cilët shpesh i hasim buzë katandisjes fizike. Që në faqet e para të romanit “Fatprerët” ballafaqohemi me një atmosferë të trishtuar e pa perspektivë të burgut hetues e të zandanit. Malë Proka te romani “Fatprerët” i lindur me psikologjinë se liria qëndron mbi çdo vlerë, proteston në emër të drejtësisë dhe së vërtetës kundër vetëdijes autoritare, kundër forcave rënuese shpirtërore, kundra atyre që mbjellin farën e frikës dhe gjendjes së nënshtrimit. Gadishmëria e heronjëve epik për flijim nuk nënkuptohet si gjestilacione rasti, por si domosdoshmëri. Burgjet dhe zandamet ku vuajnë të pafajshmit janë perandori sëmundjesh të padukshme. Dhe sot e kësaj dite burgjet për ne shqiptarët janë bërë çerdhe torturash të ndërhuara sipas Xhelatëve.

Në këtë perandori pushteti është në duartë e errësirës, kurse njerëzit viktimat e tyre. Është roman autobiografik (ku flitet për vet jetën e autorit). Ngjarja rrëfëhet në dy kohë: koha e burgut (koha e përjetuar nga vetë autori) dhe koha jashtë burgut që është e kaluara. Personazhet janë real dhe të imagjinuar. Ngjarja paraqitet në vepër në disa kategori shtresash njerëzish, si katundarët dhe anëtarët e vetë familjes. Mal Proka personazhi kryesor pas të cilit fshihet vetë autori. “Banesa në katin e tretë” është kontunitet i veprës “Fatprerët”. Babai për të është kult hyjnor, e mitizon atë në të gjitha veprat e tij. Kategori tjetër e njerëzve janë të tjerët spiunët, tradhëtarët, udbashët, njerëzit të cilët e bëjnë dhunën mbi të burgosurit. Këta njerëz janë kategoria më e fëlliqur, kategoria manipuluese që paguhen për një shërbim. I burgosuri politik Mal Proka është intelektual. Malën e akuzojnë për vdekjen e shokut të qelisë, sikur ai e ka mbytur atë. Këto janë moment reale që i ka përjetuar edhe vet autori gjatë kohës që ishte në burg.

E gjithë vepra është një komunikim i një retrospektive që autori i tregon ngjarjet. Ai ka qenë pre e një politike sllave që është bërë ndaj shqiptarëve. Te romani “*Fatprerët*” hasim shumë meditime për jetën dhe vdekjen, që më së shpeshti jepen nëpërmjet monologut të brendshëm. P. sh. ” *Vdekja është trishtuese si parandjenjë, por jo aq e rëndë si akt. Sa më shumë i trembesh asaj, aq më shumë i shtrëngon prangat e robëris*” (...) ” *Jetë paska qenë edhe ajo që e sheh larg edhe ajo që e pret afër*”. Kur flitet për temën e dashurisë personazhët besojnë në fuqinë e dashurisë dhe janë të gatshëm që të flijohen për të. Dashuria është e çiltër, e pastër, e sinqertë, pa

dredhira e prapaskena, kurse personazhët negativë janë të dhënë ose pas pasionit, fizikut të tjetrit, ose janë të egër dhe nuk dinë të dashurojnë. Gruaja për ta është vetëm fiziku i saj, kurse për personazhin pozitiv është edhe ana shpirtërore, e brendshmja, e fshehura. Te romani *Fatprerët*, gjithçka fillon dhe mbaron me një të burgosur politik, i cili është dënuar pa bërë asnjë faj. Romani si i tillë, paraqet një dramë ekzistenciale të individit, i cili është mbrojtur me humanizëm dhe dashuri për njeriun, por padrejtësisht i ekspozohet represionit dhe cinizmit të një regjimi totalitar. Në qendër është pozita e intelektualit liridashës në raport me shoqërinë e mbyllur dhe paranojake; një temë e preferuar në letërsinë shqipe. Personazhi Malë Proka, për dallim nga personazhët e disa romaneve shqiptare, që paraprakisht kanë të formësuar vetëdije të lartë kritike mbi zhvillimet në shoqëri, nuk është aq i interesuar për ngjarjet që ndodhin jashtë botës së tij. Është idealisti që beson se popujt duhen të jenë të lirë dhe të barabartë. Horizonti i botëshikimit të tij zgjerohet në çastin kurë bëhet viktim e cinizmit institucional. Ai është personazhi dinamik që pëson transformim, sepse është vuajtja që e bën të vetëdijshëm jo vetëm për gjendjen e tij, por edhe të njerzëve të tjerë që gjallojnë brenda një sistemi të egër, i cili e legjitimon dhunën. Ai bindet se “*në kushtet e burgut hetues përpjekja për luajalitet me satrapët është gafë e madhe.*¹

1. Shqyrtime etnokulturore

a) Përdorimi i nofkave

Nofkat e mbledhura në romanin “*Fatprerët*” të Murat Isakut janë këto: *I dyti (shoku i qelisë), Zhapiu i natës (gardiani), Vragaballi, Yll i Sabahut, Bajrak i Madh, Malë Sokoli, Malë Biga, Katër Katri, Ylli i fshatit, Panteon i Dashurisë, Zëri i Mëmëdheut, Yll i Karvanit, Tringa e maleve, Luciferi, Fakiri, Gjeraqina, Hundëkërruti, etj.*

b) Përdorimi i eufemizmave

Eufemizmat e mbledhura në romanin “*Fatprerët*” të Murat Isakut janë këto: *Inati i mushkës, ogurbadhi (burgu), Ylldashur, lokmirë, Qelia numër katër, E bukura e dheut, Epidemia e inatit, sklerotik, Qelia numër 23, Zogu i Pranverës, Nurbardhi, etj.*

¹ Isaku, Muart, “*Fatprerët*”, Tetove, 1995, fq.70

c) Përdorimi i urimeve dhe fjalëve përkëdhelëse

Gjatë analizës së romanit “*Fatprerët*” të Murat Isakut arritëm t’i gjejmë këto urime dhe fjalë përkëdhelëse, të cilat prindërit i përdornin për t’i uruar fëmijët e tyre në mënyra nga më të ndryshmet si : *Rrofshim e qofshim për këta fatprerë rekuizitat e dhunës; O trim, o cub të prehtë e mira; Zotynë më ndje! Hapi kulmet mbi të gjitha burgjet e botës, që të shihet qielli ynë! Zotynë më ndje, Zotynë!; Të marrtë e mira , të marrtë e më paç uratën e të Madhit; O Zot, O Perëndi falju zemër njerëzve, që kanë humbur rrugën në prag të derës, amin,amin,amin!; O Zot ruajma Morenë e dashur jetën dhe shpirtin e saj, o Zot më ndje; Me këmbë të mbarë e na u bëfshin katund; Të mira e gëzimë , paç ; Or të priftë e mabara; Shëndet paçin; Mashalla, paç jetë e gëzime; Pirrolla gjirit të asaj nëne; Paç faqen e bardhë!; U prift Zoti kah e mbara!; Qoftë me nder;*

c) Përdorimi i mallkimeve popullore

Gjatë analizës së romanit “*Fatprerët*” të Murat Isakut arritëm t’i gjejmë këto mallkime popullore: *Në dreq të mallkuar, Sot e mot, mallkuar; Haje dreq kokallën e Bigasit, Qit një pushkë, or i mallkuar, or tmerr, or mizor; Kuku, kuku, kuku për qyqen e malit!; Kuku për fatprerin e zi! ; I marroftë Zoti, sa të poshtër që janë; Dreqi ta hajë atë farë; Iu preftë nafaka; Hajt këput kryet, qafir; Mos pingroftë mushkë në derë të robit; Xanxarja e shëmtuar; Më rafshin flokët e kresë e u bëfsha sorrë mali; Haje dreq kollaren e Bigasit; Hi e pluhur u bëftë i Madhi, zanofhtë nama e nënave, u farroftë Zotynë!;Mbetshi qeqe në një mal; Të hajë dreqi i mallkuar; O më raftë pika në kupë të kresë e, mos më pafshin sytë e ballit dritë të bardhë; Më vraftë buka e Zotit; Të raftë rrufeja; Në lis u thafsha si eshkë, flokët më zënshin myshk, u djegtë kullosa prej mallkimit;*

d) Përdorimi i ngushëllimeve

Gjatë analizës së romanit “*Fatprerët*” të Murat Isakut arritëm t’i gjejmë këto ngushëllime që shprehen më shumë: *Atë bir Zoti tash e ha dheu, pastë dritë, amin! ; Urata e Zotit dhe trualli t’u bëfshin të lehtë, or i Dytë, Amin!; Ndjesë paç, or Malë Proka nga Biga, dheu t’u bëftë i lehtë dhe Zoti pastë mëshirë ; Ndjesë paç or Malq Proka nga Biga , paç uratën dhe truallin e lehtë në varr!; Paçin dritë, paçin dritë; Rahmet pastë; Qofshi ju shëndosh e mirë, se Malë Proka, nga Biga, ju ka lënë; Rahmet Paç; etj.*

dh) Ofendimet (sharjet)

